



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Datë 09.10.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi –nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

- 1 Miratimi i procesverbaleve të datave 18 dhe 26 shtator 2018.
- 2 Seancë dëgjimore me zëvendësministren e Financës dhe Ekonomisë, zonjën Dajna Sorensen, për fillimin e vitit të ri shkollor në sistemin parauniversitar të arsimit dhe formimit profesional.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Vilma Çoba, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Fatmir Velaj, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela dhe Almira Xhambulla.

Mungojnë:

Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Nora Malaj, Kejdi Mehmetaj dhe Shezai Rrokaj.

Të ftuar:

Dajna Sorensen - zëvendësministre e Financës dhe Ekonomisë,
Stavri Lako – përgjegjës sektori në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë,
Elira Caushi - drejtore e Përgjithshme në Shërbimin Kombëtar të Punësimit,
Etleva Gjellaj - drejtore e Formimit Profesional në Shërbimin Kombëtar të Punësimit.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi - Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e komisionit. Për fat të keq edhe sot përfaqësuesit e opozitës nuk kanë ardhur. Ne do të vazhdojmë të bëjmë detyrat tona parlamentare.

Sot në rend të ditës është dëgjesa në lidhje me situatën e arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri me fillimin e vitit të ri shkollor 2018-2019. Ka qenë një kërkesë e kahershme e komisionit, së bashku edhe me kolegët opozitarë, që të kishim zonjën Sorensen këtu për të na folur për situatën e arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri.

Zoti Ylli, a e kemi kuorumin e përshtatshëm?

Fidel Ylli- Po, kuorumi është i plotë, jemi të 10 anëtarët, madje pa anëtarët zëvendësues.

Milva Ekonomi – Për këtë dëgjese, e cila është kërkuar javën e kaluar, opozita është njoftuar. Kemi thirrur zonjën Dajna Sorensen, zëvendësministre e Financës dhe Ekonomisë; Stavri Lako, përgjegjës sektori në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë; Elira Caushi, drejtore e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit; Etleva Gjellaj, drejtore e Formimit Profesional të Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Dajna Sorensen – Faleminderit!

Në prezantimin tim unë do të thosha që arsimi dhe formimi profesional nuk janë të ndarë nga tregu i punës dhe nuk janë qëllim në vetvete, por janë në funksion të përmirësimit të mundësive të rinjve dhe të rejave, të personave të gjitha grupmoshave për t'u integruar dhe për të mbetur relevantë në tregun e punës.

Unë do të paraqes situatën e punësimit dhe arsimit profesional në përgjithësi, para se të kaloj në elementet e arsimit profesional në veçanti. Kështu, duke filluar nga viti 2013 punësimi dhe rritja ekonomike për herë të parë kanë filluar të ecin paralelisht. Kjo ka të bëjë, së pari, me ndryshime strukturore në ekonomi, të cilat janë edhe orientimi i ekonomisë drejt sektorëve me një produktivitet më të lartë. Pavarësisht trendeve pozitive, papunësia në nivel kombëtar mbetet në nivelin 12,4%, për të rinjtë. Ata të cilët janë në grupmoshën mbi 50 vjeç, personat me aftësi të kufizuar dhe gratë janë grupe të cilat kanë një hendek më të madh për t'u integruar në tregun e punës.

Ndjekja e arsimit ka pasur rritje të vazhdueshme në të gjitha nivelet arsimore, me synim përmirësimin e cilësisë së burimeve dhe të kapitalit njerëzor. Megjithatë, shumë më tepër mbetet për t'u bërë këtu. Sistemi arsimor, përfshirë këtu arsimin dhe formimin profesional, ende nuk i pajis të gjithë individët me të gjitha aftësitë, që janë kaq të domosdoshme në tregun e punës dhe shumë më tepër mbetet për t'u bërë në lidhje me këtë. Ngritja e një sistemi cilësor të aftësive, i cili është i orientuar drejt nevojave të tregut, është një domosdoshmëri jo vetëm për uljen e papunësisë, për rritjen e produktivitetit, por, për më tepër, për garantimin e rritjes së vazhdueshme ekonomike.

Sa i përket arsimit profesional dhe punësimit, kuadri ynë strategjik është pikërisht strategjia kombëtare për punësim dhe aftësim 2014-2020, e cila ka synimin për aftësi më të larta dhe punë më të mirë për të gjithë, edhe për femrat, edhe për meshkujt në Shqipëri. Strategjia ka 4 prioritete: së pari, të nxisë mundësitë për punësim të denjë nëpërmjet politikave të tregut të punës; së dyti, të ofrojë arsim dhe formim profesional të cilësor për të rinjtë dhe të rriturit. Ky është një element shumë i rëndësishëm, sepse ne po flasim vazhdimisht për arsim profesional gjatë të gjithë jetës. Komponenti i tretë ka të bëjë me nxitjen e përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial dhe, komponenti i katërt, ka të bëjë me fuqizimin e qeverisjes së tregut të punës dhe sistemit të kualifikimeve.

Gjithashtu, një nga objektivat e programit të qeverisë 2017-2021 është rritja e punësimit, duke ulur papunësinë në nivelin njëshifror. Objektivi i dytë është përgjysmimi i diferencës midis papunësisë rinore dhe papunësisë së përgjithshme, ngritja e një fuqie punëtore me arsimin dhe aftësitë e duhura në sektorë prioritarë, siç janë: turizmi, bujqësia, agropërpunimi, teknologjia e informacionit dhe e komunikimit. Është shumë e rëndësishme që ne të flasim për sektorë, të cilët mund të gjenerojnë punësim për të gjithë shqiptarët, jo vetëm ato që ndodhen në aksin Tiranë-Durrës, por në të gjithë Shqipërinë. Turizmi, agropërpunimi, teknologjia e informacionit janë sektorë, të cilët kanë mundësi për të gjeneruar shumë më tepër punësim për të gjitha grupmoshat.

Objektivi i fundit që do të doja të nënvizoja është përfshirja e atyre të cilët janë përfitues të skemave pasive, siç është ndihma ekonomike, përfshirja dhe integrimi gradual i tyre në tregun e punës.

Treguesit kryesorë të tregut të punës janë 3 gjithsej, por unë do të doja të përqendrohesha te shkalla e pjesëmarrjes së individëve në forcat e punës. Duke e krahasuar me vitin 2013, në nivel kombëtar pjesëmarrja ka qenë 57,9%, por aktualisht ka arritur në masën 68% dhe Shqipëria është

një nga vendet e rajonit që ka pjesëmarrjen më të lartë në forcat e punës. Në fakt, këtu kemi një hendek gjinor, sepse pjesëmarrja e grave në forcat e punës është gati 18% më pak se e burrave. Gjithashtu, kemi një diferencë në shkallën e pjesëmarrjes në vend sipas grupmoshave. Ata që janë në moshën primare të punësimit 30-64 vjeç, kanë një shkallë pjesëmarrjeje në forcat e punës gati 80 %, ndërsa të rinjtë kanë një shkallë pjesëmarrjeje shumë më të ulët se grupmoshat e tjera.

Gjithashtu, është shumë e rëndësishme që ta shohim pjesëmarrjen në forcat e punës në bazë të nivelit të tyre arsimor. Në fakt, grupmosha 15-24 vjeç ka pjesëmarrjen më të ulët në Shqipëri në tregun e punës, 22,1%, ndërsa ata të cilët kanë nivelin arsimor më të lartë, pra janë me arsim të lartë, kanë pjesëmarrjen 83,7%. Pra, është një element sa i përket pjesëmarrjes në forcat e punës dhe një element i dytë shumë i rëndësishëm është niveli arsimor i këtyre individëve. Një element që unë doja ta analizoja është edhe shkalla e punësimit. Në vetvete niveli arsimor ka një diferencë midis atyre që kanë mbaruar arsimin e mesëm bazë, krahasuar me ata që kanë mbaruar arsimin e mesëm profesional. Ata, të cilët kanë mbaruar arsimin e mesëm profesional kanë më shumë mundësi punësimi në tregun e punës dhe këto të dhëna janë nga anketa e forcave të punës.

Sa i përket shkallës së papunësisë në vend, ajo ka qenë në një rënie të vazhdueshme. Aktualisht në tremujorin e fundit shkalla e papunësisë ka arritur në nivelin 12,4% për grupmoshën 15+, ndërsa për të rinjtë kemi nivelin më të ulët të papunësisë që kemi pasur ndër vite aktualisht deri 22,6%. Një tjetër element që do të doja të nënvizoja është se, në qoftë se ne shohim shkallën e papunësisë të grupmoshës 30-64 vjeç, ajo në vetvete është më e ulët dhe thuajse ka arritur nivelin 1-shifror në masën 10%.

Për sa i përket shkallës së punësimit në vend, femrat kanë një shkallë punësimi më të ulët sesa meshkujt, megjithatë është shumë e rëndësishme që në nivel kombëtar ne kemi një shkallë punësimi në masën 59,2%, i cili sërish është një nga nivelet më të larta në rajon. Gjithsesi, duhet nënvizuar që hendeku gjinor është në masën 14%.

E njëjta situatë është edhe sa i takon ndarjes së grupmoshave, ku, kuptohet, të rinjtë kanë një shkallë punësimi më të ulët sesa grupet e tjera. Për sa i takon nivelit, ndoshta në disa *slide* po i kaloj dhe po shkoj direkt te një çështje tjetër.

Doja të nënvizoja se, kur flasim për arsimin dhe formimin, flasim për dy elemente kryesore, e para është arsimi profesional dhe e dyta formimi profesional. Arsimi profesional në Republikën e Shqipërisë ofrohet në nivelin e arsimit profesional të mesëm, ku programet janë deri

në 4 vjet, 2+1+1 ose 2+2, të cilat ofrohen në 35 institucione të arsimit profesional. Në prezantimin që po ndaj me ju, do të shikoni se në vitin 2017 numri i personave, të cilët ndoqën arsimin profesional të mesëm, arriti në 19019. Aktualisht, për vitin e ri akademik 2018-2019, numri i regjistrimeve mbetet rreth të njëjtit nivel.

Konkretisht, janë regjistruar në vitet e para të shkollave profesionale 5612 nxënës në këtë vit akademik. Mesatarja gjatë viteve 2014-2018 ka qenë 5200 deri në 5800 regjistrime të reja në vit, prandaj është shumë e rëndësishme që këtë ta vendosim në një kontekst. Numri i nxënësve që po mbarojmë klasat e 9-ta dhe që janë kontingjenti për shkollat profesionale apo për arsimin e mesëm është në rënie. Fakti që jemi duke mbajtur këtë nivel është një element shumë pozitiv, sepse një shumicë e madhe e shkollave tona janë duke performuar në kapacitet ose, në disa raste, edhe mbi kapacitetin e tyre. E thënë në terma shumë relativë, në 2013-ën vetëm 13-14% e nxënësve, të cilët mbaronin shkollat 9-vjeçare, ndiqnin arsimin dhe formimin profesional, ndërsa aktualisht jemi në masën 20% të atyre që mbarojnë arsimin 9-vjeçar dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional. Kuptohet që drejtimet që ofron arsimit dhe formimi profesional janë nga më të ndryshmet, ku aktualisht ofrohen 26 drejtime të ndryshme me fusha specializimi të veçanta, por jo të gjitha janë atraktive për të rinjtë; ka disa profesione ose drejtime, të cilat janë më të preferuarat.

Nga 5612 nxënës që ju përmenda më parë, të cilët janë regjistruar në arsimin profesional, 1149 nxënës janë këtë vit për hoteleri-turizëm, 784 nxënës janë për shërbimet e mjeteve të transportit, 574 nxënës janë për teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit. Fusha të tjera të preferuara janë: elektroteknika, termohidraulika, mekanika, teknologjia ushqimore dhe teksa shkoj më poshtë në listë, kuptohet që numri i nxënësve të regjistruar është më i ulët.

Gjithashtu, ka preferenca për shkolla të caktuara, siç janë shkollat e Tiranës, të cilat kanë një ndjekje shumë të lartë. Këtu do të nënvizojë Shkollën e Hoteleri-Turizmit që ka 947 nxënës, shkollën “Gjergji Canco”, që ka 938 nxënës, shkollën “Karl Gega” me 1200 nxënës, Shkollën Ekonomike dhe Kamza, e cila aktualisht ka 1815 nxënës. Shkollat e qytetit të Elbasanit kanë një pjesëmarrje shumë të lartë, siç janë shkollat “Ali Myftiu” dhe “Sali Ceka”, të cilat së bashku kanë 1600-1700 nxënës.

Ndër shkollat, të cilat kanë pësuar një rritje shumë të madhe në numrin e nxënësve, sidomos vitin e fundit, do të nënvizojë, në radhë të pare, Shkollën Tregtare në Vlorë dhe shkollën “Kolin Gjoka” në Lezhë, të cilat, falë ndërhyrjeve të mëdha që janë bërë, kanë pasur një interes dhe rritje të numri të nxënësve, si dhe shkolla “Hamdi Bushati”, e cila ka pasur një rritje me 50%

të numrit të nxënësve krahasuar me vitin e kaluar. Po ashtu shkolla “Arben Broci”. Kanë një ndjekje të madhe shkollat e Durrësit, ku në dy nga këto shkolla ka rreth 3000 nxënës, shkolla “Petro Sota” në Fier, Shkolla Mekanike në Lushnjë. Pra, këto janë disa prej shkollave, të cilat kanë ndjekjen më të madhe.

Një element që është nënvizuar vazhdimisht dhe që është mjaft i rëndësishëm, është fakti se një pjesë e shkollave tona kanë pasur ndryshime shumë substanciale në infrastrukturë. Vetëm këtë vit janë rikonstruktuar disa prej shkollave, konkretisht ndërtimi i bazës prodhuese të shkollës “Karl Gega” në Tiranë, rikonstruksioni i shkollës profesionale në Kamzë, shkolla “Ali Myftiu” në Elbasan, faza e dytë, baza prodhuese e shkollës “Petro Sota” në Fier, shkolla “Kristo Isak” në Berat, ndërtimi i shkollës profesionale “Beqir Çela” në Durrës. Në qoftë se ju jeni të interesuar, mund t’ju jap edhe shifrat konkrete të investimeve për secilën prej këtyre shkollave.

Janë në proces tenderimi edhe dy shkolla të tjera, Hoteleri-Turizmi në Tiranë dhe ndërtimi i shkollës së re “Gjergji Canco” dhe “Hermann Gmeiner” po në Tiranë. Gjithashtu, kam të dhëna për nivelin e investimeve ndër vite dhe në qoftë se ju jeni të interesuar, mund t’jua pasqyroj.

Sa i takon kuadrit ligjor të arsimit dhe formimit profesional, është ligji nr. 15, “Për arsimin dhe formimin profesional” që ka kaluar në vitin 2017, i cili përbën bazën ligjore kryesore për arsimin dhe formimin profesional. Ligji në vetvete solli një sërë risish, ku do të doja të nënvizoja, në radhë të pare, faktin që ky ligj trajton në mënyrë të veçantë strukturën e arsimit dhe formimit profesional dhe i jep një rëndësi të veçantë arsimit dhe formimit profesional, si një mënyrë për t’u integruar në tregun e punës.

Përtej promovimit të arsimit dhe formimit profesional si një mënyrë shumë e mirë për t’u integruar në tregun e punës, ligji nënvizon edhe disa elemente që janë shumë të rëndësishme, si cilësia në arsimin profesional. Përtej nevojës për t’i orientuar dhe drejtuar të rinjtë dhe të rejtat në arsimin profesional, është e domosdoshme që paralelisht të fokusohemi edhe te cilësia e mësimdhënies në këto shkolla.

Për sa u takon elementeve të cilësisë, do të doja të nënvizoja 4 elemente që janë shumë të rëndësishëm.

E para, kurrikulat, të cilat duhet të jenë, dhe ne po punojmë fort nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit Profesional dhe Kualifikimeve për përditësimin e kurrikulave, sipas nevojave të sektorit privat.

Elementi i dytë dhe shumë i rëndësishëm është infrastruktura që ua përmenda edhe pak më parë.

Elementi i tretë është të nxënit nëpërmjet punës. Këtë çështje nuk munda t'jua nënvizoja mjaftueshëm, pasi një pjesë e të nxënit ndodh brenda mjediseve të shkollave, por është mjaft e rëndësishme edhe nxënia që ndodh brenda ambienteve të ndërmarrjeve. Në këto vende të rinjtë dhe të rejtat pajisen jo vetëm me aftësitë teknike, kaq të domosdoshme për profesionet respektive, por mbi të gjitha ata pajisen me njohuritë dhe aftësitë e duhura që janë mjaft të rëndësishme në tregun e punës.

Element mjaft i rëndësishëm është edhe cilësia e mësuesve dhe instruktorëve në arsimin dhe formimin profesional. Duke filluar nga vitit 2016 mësuesit e arsimit dhe formimit profesional gradualisht janë duke u trajnuar dhe duke marrë një trajnim 24-ditor për bazat e didaktikës. Vetëm vitin aktual janë trajnuar 116 mësues dhe deri në fund të këtij viti do të trajnohen në total rreth 200 mësues, një element mjaft i rëndësishëm ky për të garantuar cilësinë në arsimin dhe formimin profesional. Një gjë tjetër, që dua të nënvizoj, është që në sektorin e punësimit dhe të arsimit profesional kemi një numër shumë të madh donatorësh, të cilët kanë asistuar për të përmirësuar cilësinë e arsimit dhe formimit profesional, ku do të përmendja, në radhë të parë, Bashkimin Europian, me kontratën e mbështetjes buxhetore sektoriale, që në total është pothuajse 30 milionë euro.

Për sa u përket donatorëve bilateralë, do të përmendja qeverinë e Zvicrës, qeveritë gjermane, austriake, italiane, të cilat aktualisht kanë portofola shumë substanciale të mbështetjes së arsimit dhe formimit profesional.

Në faqen e Ministrisë së Financave ju mund të gjeni edhe raportet vjetore për zbatimin e strategjisë së punësimit dhe aftësimit në Shqipëri. Raporti i fundit për vitin 2017, u publikua në qershor të këtij viti. Në këtë moment jemi duke ndërmarrë edhe vlerësimin afatmesëm të strategjisë, që presupozohet se do të konkludojë brenda këtij fundviti dhe do të ketë një plan veprimi të veçantë.

Elementi i fundit që doja të nënvizoja, ka të bëjë me mbështetjen buxhetore sektoriale që ne marrim nga Bashkimi Europian. Jemi një nga sektorët që ka nivelin më të lartë të arritjeve, të indikatorëve, që janë të vendosur për të përfutur këtë vlerë financiare. Nga 7 indikatorë që kishim për vitin 2017, arritëm të plotësonim 6,5. Kjo përbën një arritje shumë të madhe, që është vlerësuar edhe nga Bashkimi Europian.

Përpara se të konkludoj, doja të flisja edhe për formimin profesional. Formimi profesional, në vetvete, targeton të gjithë ata që nuk ndjekin arsimin e mesëm profesional, por që kanë nevojë të marrin aftësi në një fushë të caktuar, me anë të kurseve afatshkurtra, të cilat varrojnë nga disa javë, në disa muaj.

Dua t'ju jap disa shifra, për sa i përket ndjekjes së formimit profesional në Shqipëri. Aktualisht, gjatë 2018-s, duke filluar nga janari deri në gusht, 10 mijë e 52 individë kanë ndjekur kurse afatshkurtra, nga të cilët 4310 janë femra. Bëhet fjalë vetëm për 8 muajt e parë të vitit. Ndër programet e ndryshme që ndiqen, instalimi dhe riparimi i rrjeteve elektrike ka ndjekjen më të lartë, me 11% të totalit të të certifikuarve; hidraulikët, me 7,7%; kursi i kuzhinës, gjithashtu, është shumë i ndjekur dhe preferohet. Rreth 9,6% e totalit të atyre që kanë marrë certifikata gjatë kësaj periudhe, ndjekin pikërisht këto kurse. Gjithë e huaja, gjithashtu, kanë një vlerë substanciale, pavarësisht se janë në rënie këto vitet e fundit.

Kemi informacion të detajuar nga 10 qendra që ekzistojnë në Shqipëri, për ndjekjen në secilën prej këtyre qendrave, se sa ka qenë ajo edhe sipas grupmoshave. Është shumë e rëndësishme të nënvizojmë që një nga kontingjentët, që ne mundohemi ta targetojmë nëpërmjet qendrave të formimit profesional, është ai i punëkërkuarve të papunë. Paralelisht, duam të nënvizojmë edhe faktin që integrimi i tyre në tregun e punës vështirësohet shumë, duke pasur parasysh nivelin arsimor të këtyre punëkërkuarve. Aktualisht, mund të themi se 92% e të gjithë punëkërkuarve të papunë, të regjistruar pranë zyrave të punës, kanë arsim të mesëm ose më pak, si dhe rreth 80% e tyre kanë vetëm arsim 9-vjeçar ose më pak. Ata janë kontingjenti ideal për t'i aftësuar nëpërmjet kurseve të formimit profesional dhe për të mundësuar integrimin e tyre në tregun e punës.

Faleminderit!

Jam e hapur për çfarëdolloj pyetjesh që mund të keni.

Milva Ekonomi - Faleminderit shumë, zonja zëvendësministre!

Kolegët pjesëmarrës, kanë diçka tjetër për të shtuar?

Jeni gati për të bërë disa pyetje? Si e kemi radhën e pyetjeve? Ismeti përpara, më pas Fadili. Edhe unë kam renditur disa pyetje.

Kush do tjetër të bëjë pyetje? Vilma dhe Bujari më pas.

Ismet Beqiraj – Përshëndetje!

Kjo mbledhje e Komisionit për Edukim dhe Mjetet e Informimit Publik, që bëhet në fillim të vitit akademik, ka një rëndësi të veçantë, sidomos për arsimin dhe formimin profesional.

Duke respektuar edhe përfaqësuesen, zëvendësministren, për të gjithë ato çfarë tha, për ato çka paraqiti, pyetjet e mia do t'i bëj pak më të thjeshta, që edhe njerëzit të na kuptojnë, mbi realitetin, se si është, çfarë është bërë dhe se ku duhet të shkojë arsimi dhe formimi profesional; ku përgatiten specialistët e të gjitha fushave, që ndërtojnë, zhvillojnë dhe plotësojnë tregun e punës në Shqipëri.

Në fillim, kam një sugjerim: herën tjetër këto materiale të na dorëzohen në kohë, që edhe ne të jemi të integruar, qoftë me pyetjet, qoftë me situatën, dhe jo gjatë mbledhjes. Ndaj, zonja drejtuese e mbledhjes, këtë ia kërkoj edhe shërbimit këtu në komision. Në radhë të parë, këtë e kam si vërejtje.

Kam disa pyetje.

A është bërë tipologjia e profesioneve, në funksion të kërkesave dhe profilit ekonomik dhe social, sipas bashkive në të gjithë vendin? Sepse një nga objektivat e kësaj qeverisjeje, është që mbi bazën e tipologjisë së profesioneve, në çdo bashki duhet të ngrihen shkollat e formimit profesional.

Së dyti, cili është projeksioni juaj për ngritjen dhe zhvillimin e arsimit profesional në zonat naftëmbajtëse dhe mineralmbajtëse, sidomos për shkak edhe të implementimit të shpejtë të statusit të naftëtarëve dhe të minatorëve? E kam bërë edhe më parë këtë pyetje dhe nuk shikoj ndonjë dritë në fund të tunelit që ky problem të zgjidhet.

Lidhur me investimet kapitale, në buxhetet që ne kemi miratuar vitin e kaluar, në buxhetin 2018, për infrastrukturën e arsimit dhe formimit profesional, synohet ndërtimi i 6 shkollave të reja. Nuk u dha asnjë informacion se sa është niveli i këtij i investimi. A është prerë ndonjë shirit në këtë fillimviti, se nuk e morëm vesh? U tha vetëm në frymë të përgjithshme.

Sikurse edhe në arsimin parauniversitar, janë ndërmarrë reforma, një sërë nismash, janë bërë edhe ndërhyrje në ligjin “Për arsimin parauniversitar”, me të drejtë, që reflektojnë edhe reformat që janë bërë. Pyetja imë është: Në lidhje me kurrikulën, kontrollin e nivelit cilësor, rekrutimin e lidërshit drejtues dhe mësimdhënës, secila zonë dhe secila shkollë vepron e unifikuar apo sipas një eksperience thjesht të trashëguar?

Pyetjen e fundit e kam për Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Ka një gjë që më shqetëson dhe do ta shtoj pyetjen jo vetëm për arsimin dhe formimin profesional,

por edhe për specialistët e lartë, që mbarojnë në shumë institucione të arsimit të lartë. Në lidhje me marrëdhëniet institucionale qoftë të ministrisë, qoftë të arsimit dhe formimit profesional, qoftë edhe të institucioneve të arsimit të lartë, a ka marrëdhënie ligjore ose marrëdhënie *partnershipi* midis punëdhënësit dhe punëmarrësit? Këtë pyetje e kam ngritur edhe herë tjetër, sepse neve hapim shkolla profesionale, por ku do t'i bëjnë nxënësit praktikat profesionale? Në themel të kurrikulës sonë është kompetenca, në mënyrë që nxënësi atë që mëson dhe studion, duhet ta zbatojë. Kjo gjë shtrihet deri në institucionet e arsimit të lartë, sepse studentëve nuk u hapet dera në një ndërmarrje apo një sipërmarrje private me koncesion, ose edhe publike. Këtë shqetësim unë nuk e sjell më kot, sepse jam marrë me hartimin e kurrikulave të shkollave profesionale në industrinë kimike. Një nga problemet që kolegët në këto shkolla sillnin ishte deficienca në aspektin e marrëdhënieve institucionale ndërmjet institucioneve të arsimit profesional dhe kompanive të ndryshme, që operojnë në tregun privat dhe çdo gjë i është dhënë privatit. Një problem i tillë është sepse këto kompani janë jashtë kontrollit të zyrave të punësimit dhe nuk respektojnë detyrimet që kanë, por nuk është kjo tryeza, gjë të cilën unë si deputet do ta kërkoj edhe në shumë aspekte të tjera, që ka të bëjë me punëmarrjen. Pra, këto kompani nuk e njohin autoritetin e drejtimit të zyrave të punësimit. Unë kam një rast konkret, që ka të bëjë me kompanitë koncensionare të naftës.

Milva Ekonomi – Unë propozoj që ju t'i mbani të gjitha pyetjet shënim dhe, më pas, të na jepnit një përgjigje, meqenëse janë disa deputetë që duan të bëjnë pyetje.

Po, zoti Fadil.

Fadil Nasufi – Në fakt, duhet përshëndetur programi i qeverisë për formimin profesional, sepse është në rrugë të mbarë dhe ka sjellë një ndryshim thelbësor qoftë në fushën e investimeve, qoftë në fushën e tërheqjes, frekuentimit dhe arsimit profesional. Ne jemi në hapat e parë të kësaj pune.

Meqenëse zëvendësministrja iu referua një informacioni shumë të gjerë, duke prekur edhe problemet e punëdhënësit, problemet e shërbimeve sociale e me radhë, unë kam disa pyetje konkrete.

Pa dyshim, unë e mbështes nismën dhe reformën e thellë kundër informalitetit, që kemi bërë në këta 5 vjet qeverisjeje edhe në fushën e papunësisë. Ju raportuat se shifra e papunësisë është 12,4%. Tashmë dihet se si i gjetëm shifrat, dihet se kush e ka dhënë modelin e statistikave që prodhojmë ne apo që prodhoni ju, sepse jeni institucioni bazë si Ministri e Ekonomisë dhe Financave, që ushqeni jo vetëm opinionin publik, por edhe qeverinë me shifra përkatëse. A dini të

më thoni sa të punësuar ka në fshat? Cilët nga këta janë agrobiznes që marrin një pagë? Cilët janë ata që prodhojnë për të tretë dhe marrin një pagë? Cilët janë ata që rropaten në tokën e tyre, por figurojnë si të punësuar dhe nuk kanë asnjë të ardhur? Dihet se në Shqipëri mesatarja e tokës për një familje në shkallë kombëtare është 1,2 hektar.

Këtë e them për tri probleme: kjo shifër bie ndesh me të dhënat e rajonit, të cilat e kanë shumë të lartë; kjo shifër na kthehet në kosto për të fituar grante për çështjen e papunësisë dhe varfërisë nga BE-ja, si dhe kjo çështje duhet të jetë shumë e adresuar për problemet reale, që nuk duhet të jenë thjesht statistika dhe shifra zyresh. Por duhet të jenë probleme të vërtetash që ndeshim ne. Kur flasim këtu, duhet të kemi parasysh njerëzit që janë në këtë situatë.

Për sa i përket arsimit profesional, a kemi probleme me tekstet e arsimit profesional? A bëjnë pjesë në të njëjtën agjendë, siç janë për arsimin parauniversitar, që kanë të bëjnë me një reformë shumë të thellë, sepse sot ka tekste model që u referohen modeleve të Kembrixhit, të Oksfordit e kështu me radhë?

Së dyti, a parashikohen stimuj për frekuentimin e shkollave profesionale për nxënësit, bursa nga bashkitë apo bursa nga ministria? Ne ende jemi në një ritëm që janë 19 mijë, por përsëri më shumë në territor dominojnë gjimnazet sesa shkollat profesionale. Këto shkolla duhet të jenë në akord me vizionin që ka qeveria për të ngritur një shkollë profesionale, sipas tipologjisë dhe profilit që ka specifikisht çdo bashki për zhvillimin social-ekonomik. A ka probleme lidhur me e stafin mësimor? A ecin në një agjendë, siç e ka parashikuar Ministria e Arsimit? Në shkollat profesionale, në qarqet ku jemi ne, ndeshemi në faktin se ka punonjës që janë aty nga halli. Domethënë, ka specialistë, të cilët punojnë në këto shkolla, por nuk kanë CV-në e duhur për ta ushtruar praktikisht dhe për të dhënë atë model. Unë deri më sot, me ç'kam lexuar, por edhe nga e gjithë tradita e brezit tim, kam si model shkollën "Harry Fultz". A kemi ne modelin më të mirë sot, që ngjiz teoria me praktikën dhe lidhja me kontratën e punës të këtij brezi të ri që po formojmë? A kemi ne një model tipik? Ne kemi dashamirësinë e donatorëve zviceranë, gjermanë, austriakë, të cilët po bëjnë maksimumin qoftë me asistencë, qoftë me donacione, qoftë edhe me modelet e tyre, por gjithsesi duhet t'i kthehemi një tradite, që ka qenë me shumë emër, siç është shkolla "Harry Fultz". Kjo shkollë ka qenë universiteti i kohës për brezin e viteve '30. A kanë lehtësi bizneset për nxënësit praktikantë që marrin? Si ndiqet gjurmimi i nxënësve që ata të motivohen për tregun e punës qoftë nga zyrat e punës, qoftë nga bizneset, sepse praktikisht ne ndeshemi me paradokse të tilla? Për shembull, në shkollën "Kristo Isak" sot nuk ka asnjë klasë me profile

përkatëse dhe asnjë nxënës nuk u regjistrua në arsimin bujqësor, kur 25% e të gjithë të ardhurave në qarkun e Beratit i ka bujqësia, sepse ka hoteleri-turizëm, ka elektrodinamikë, ka restorante, ka termodinamikë e me radhë, por nuk ka profesionistë për nevojat që ne kemi për turizmin dhe për bujqësinë.

Një problem tjetër ka të bëjë me konviktet, të cilat janë pronësi të bashkive, sipas ligjit të transferimeve, por konviktet po tjetërsohen. A keni ndonjë strategji apo një bashkërendim, në mënyrë që nxënësit, të cilët do të frekuentojnë arsimin profesional, që vijnë kryesisht nga zonat rurale, të akomodohen në konvikte pranë shkollave profesionale apo do të vazhdojë në vetërrjedhje kjo punë dhe, më pas, secili të mos ketë një strategji të qartë të këtyre aseteve që po reduktohen?

Në pikëpamjen e legjislacionit të dy drejtorët e shkollave profesionale në Berat: “Stiliano Bandilli” dhe “Kristo Isak”, ngrenë problemin e daljes së udhëzimit për ligjin e arsimit profesional për çështjen e autonomisë së krijuar dhe për krijimin e të ardhurave, që mund të marrin ata në funksion të ligjit të arsimit profesional.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Zoti Bujar, a kishit diçka për të thënë?

Bujar Çela – Përshëndetje!

Shpjegimi i zëvendësministres ishte shterues dhe materiali i bollshëm që kemi në tavolinë na bën që të kemi më pak pyetje. Shifrat flasin më shumë se të gjitha fjalët tona. Më vjen keq, por ndërtimin e shkollave profesionale unë e shikoj përshtat me thënien shumë të drejtë të konstatuar nga Kryeministri: “Punë ka, por specialistë nuk ka”. Unë shikoj se këto shkolla po u vijnë në ndihmë, ndërsa nga vërejtjet e shokut Ismet, për të hapur shkolla profesionale në çdo qytet, më duken si njëqind lule në njëqind shkolla. Pikërisht, kur këto shkolla nisën të bëhen në çdo rreth, ra vlera dhe niveli i tyre. Nuk mund të ketë shkollë naftë në Tropojë, gjeologji dhe miniera në Lushnjë dhe shkollë pyjore në një vend ku ka gurë, për shembull, në Fier, por edhe Fieri ka disa pyje nga ana e detit që janë mbjell në atë kohë.

Shkolla Mekanike Bujqësore në Lushnjë ka disa profesione që kërkon tregu. Ne jemi dëshmitarë që ai shtet prodhoi shumë, me ato ndërtuam Shqipërinë, por ndërtuam edhe Greqinë, edhe Italinë; edhe kur dolën nga shkollat e riedukimit përsëri ata ishin të vlefshëm atje, ndërsa tani po ndodh e kundërta. Po vijnë punëtorët e paarsimuar që kanë ikur jashtë dhe kanë marrë një zanat dhe po ndërtojnë Shqipërinë sot. Prandaj ne kemi shumë nevojë për shkolla profesionale, për profesione të tipit murator, saldator e të tjerë, që janë hapur kudo.

Shkolla Mekanike në Lushnjë ka qenë në parametra shumë të mëdha dhe shumë e zgjeruar. Para dy vjetësh ka qenë një projekt, por me ndryshimet që ndodhën me kalimin në varësi të Ministrisë së Financave, nuk e di nëse vazhdon akoma ky projekt?

Kjo shkollë ka disa profesione si: hidraulik, elektrikist, elektromekanik, motorist e të tjera. A do të rikthehet në kufijtë e asaj shkolle për të cilën u ndërtua? Sepse në atë shkollë është futur edhe një gjimnaz, në një kohë kur kemi shkolla dhe gjimnaze të tjera që kanë nga një kat bosh.

Këtu është edhe konvikti, të cilin e ka në pronësi bashkia. Unë nuk e kuptoj përse konvikti është pronë e bashkisë dhe shkolla është pronë e Ministrisë së Financave, kur të dyja i ka ndërtuar i njëjti shtet. Megjithëse këto konvikte nuk shërbejnë me mensë, aty paguhet si staf roje, pastruese dhe kuzhinier, ashtu siç kanë qenë. Unë mendoj se këto janë qasje, të cilat nuk i shërbejnë as ekonomisë dhe as nxënësve.

Po të jetë që stafi juaj, megjithëse nuk folën të gjithë, nuk është i kënaqur sot, me këtë qetësi kaq të madhe, unë i uroj suksese!

Milva Ekonomi – Fjalën e ka Vilma, pastaj Fatmiri dhe Musai.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vilma Bello – Së pari, ju përshëndes dhe ju përgëzoj për të gjithë punën që është bërë deri tani në drejtim të arsimit profesional!

Me një kënaqësi legjitime dua të përshëndes dhe të përgëzoj edhe punën e të dyja shkollave profesionale në qytetin e Vlorës!

Shkolla Industriale “Pavarësia”, në vite ka treguar dhe ka avancuar jo vetëm në numrin e nxënësve, por edhe në punësimin e nxënësve që dalin nga ajo shkollë. Po ashtu, një ndryshim të jashtëzakonshëm ka pësuar edhe Shkolla Tregtare, me numrin e madh të nxënësve që janë regjistruar këtë vit në Vlorë. Ajo çfarë mbetet për t’u parë është cilësia e nxënësve që dalin nga këto shkolla, sepse, nëse në shkollën industriale ka një cilësi nxënësish të mirë, në shkollën tregtare nuk është e njëjta cilësi. Megjithatë, e rëndësishme është rritja e ndjeshme e numrit të nxënësve dhe kjo detyruesisht do ta forcojë edhe cilësinë e tyre.

Pyetjet e mia kanë të bëjnë edhe me dy prej konstatimeve që ju bëtë.

Në radhë të parë, ju folët për një hendek gjinor në punësim mes nxënësve djem dhe vajza. A ka ndonjë politikë që mendoni të ndiqni për ta ngushtuar këtë hendek?

Pyetja tjetër: A ka një rankim të shkollave profesionale në rang vendi për punësimin e nxënësve që dalin nga këto shkolla dhe sa përqind e këtyre nxënësve ndjekin arsimin universitar? A ka një raport të tuajin për këtë?

Theksuat se mjaft prej shkollave profesionale kanë përfituar investime prej donatorëve të ndryshëm, si nga Bashkimi Europian, ashtu dhe nga qeveri të ndryshme në bashkëpunim. Sa prej këtyre shkollave e kanë përfituar këtë ndihmë dhe sa ka ndikuar kjo? Unë besoj se ka ndikuar shumë, sepse kemi shembullin e shkollave profesionale në qytetin e Vlorës, të cilat kanë sjellë mjaft ndryshime.

Pyetja tjetër është në koherencë me pyetjen që bënë edhe kolegët: Sa kompani dhe biznese të ndryshme kanë qenë pritëse, pozitive dhe bashkëpunuese me nxënësit e këtyre shkollave?

Pyetja e fundit lidhet me stafin e kualifikuar që jep mësim në këto shkolla. Mësuesit e punësuar në shkollat profesionale që japin lëndë të kurrikulave të përgjithshme, nuk hyjnë sipas portalit. A ka një mendim për t'u bërë kjo, në mënyrë që të ketë një përzgjedhje edhe më të kualifikuar të këtyre mësuesve?

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, Vilma!

Fjalën e ka zoti Velaj.

Fatmir Velaj – Falënderimi i parë shkon për zonjën Sorensen, e cila është e vetmja që ka ardhur disa herë dhe është familjarizuar me problematikat e komisionit tonë.

Për sa i përket arsimit profesional dhe formimit profesional, duke pasur parasysh edhe veten time, që kam jetuar për një kohë të gjatë në hapësirën gjermanfolëse, e njoh shumë mirë rëndësinë që ka, sidomos efikasitetin e madh që ka një punë. Në Austri dhe në Gjermani, kur mbaron shkollën për mekanik, punon vetëm mekanik. Nuk është si në Shqipëri që punon edhe hidraulik, edhe elektrikist, edhe rregullon makina e të tjera. Ata janë të fokusuar vetëm në një drejtim; nëse mbaron për saldator ose elektrikist, atje punon vetëm si saldator ose elektrikist dhe nuk merresh me punë të tjera. A funksionon në Shqipëri që një person i kualifikuar për një profesion të jetë i kërkuar edhe për tregun ndërkombëtar, nesër dhe pasnesër, përveç prioriteteve që ka këtu? Pra të mos i bëjë të gjitha zanatet, që i zë dora nga pak, por të jetë i fokusuar në një profesion.

Për sa u përket shkollave profesionale të Vlorës, unë mbështes kolegen time Vilma, që Vlora ka dy shkolla pararojë, shkollën Industriale dhe sidomos shkollën Tregtare, e cila

fatkeqësisht edhe pse është shkolla e tretë më e vjetër në Shqipëri, mbas asaj të Elbasanit dhe “Harry Fultz” në Tiranë, e cila është krijuar në vitin 1924 dhe nga ku kanë dalë shumë personalitete që kanë kontribuar për ekonominë shqiptare, por që sot, ashtu siç e tha edhe Vilma, nuk është në nivelin e duhur.

Pyetja ime është: A detyrohen këto shkolla që të futen në partneritet me shkollat e tjera simotra në Europë? Pra, atë që tha Kryeministri në fjalimin që mbajti te shkolla e drejtorëve, këta drejtorë do të jenë thjesht drejtorë apo do të marrin përgjegjësi që të futen në partneritet edhe me shkollat e tjera, që jo vetëm të marrin tekstet falas, por të marrin edhe përvoja, duke shkëmbyer jo vetëm mësimdhënien, por edhe pedagogjinë në shkollat e tjera, siç është në Austri, në Gjermani, që janë shkolla të larta, të mesme, por të nivelit të lartë profesional, nga ku del me titullin inxhinier.

Për sa i përket formimit profesional, në Vlorë ka një drejtor, një zyrë të tillë, dua të di: ku shkojnë disa nxënës, çfarë u bë me ata? A ka gjetur njeri punë prej tyre, apo thjesht marrin një certifikatë dhe pastaj nuk e merr vesh njeri nëse të gjithë këtë formim që morën aty, e sollën në jetë dhe e vunë në dobi të ekonomisë, apo jo?

Kam dy probleme në shkollën e formimit profesional në Vlorë, ku dy persona janë pushuar nga puna me arsyetimin se nuk kanë shkollën e nevojshme. Dikujt që i jepet për saldator, ka mbaruar shkollën e mesme Industriale në Vlorë, që ka qenë nga shkollat më të mira në Shqipëri pas Politeknikut, i thonë se ti nuk ke një shkollë për saldator. Me sa di unë, në atë kohë dilje një mekanik i përgjithshëm dhe i studioje të gjitha këto në bazë edhe të praktikës, sepse shkolla Industriale në Vlorë ka pasur një bazë mekanike, ku secili nga nxënësit kalonte në praktikë, por edhe në ndërmarrjet që ishin atëherë. Çfarë diplome duhet të ketë dikush për saldator ose një berber? Unë nuk di të ketë shkollë për berber në Shqipëri. Deri sot këta kanë qenë njerëz që kanë punuar në praktikë, por të ketë një arsimim për berber apo për floktore, unë nuk e di ende këtë gjë. Kjo për saldaturën, i cili ka mbaruar shkollën Industriale në Vlorë dhe tani i thonë: “Pastro dollapin. Të uroj çdo të mirë në jetë!”, mua më duket e pabazë!

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Po, zoti Ulqini.

Musa Ulqini - Faleminderit, zonja kryetare!

Ju falënderoj shumë për seriozitetin e të gjitha rasteve kur ju kemi ftuar në këtë komision, gjithmonë, dhe kjo ka qenë një nga cilësitë tuaja dhe të ekipit tuaj!

Personalisht mendoj se arsimi profesional është një nga arritjet më serioze të kësaj qeverisjeje, është një kthesë e jashtëzakonshme dhe pavarësisht nga problemet dhe vërejtjet që mund të bëjmë këtu, dhe mund të ketë shumë vërejtje, shqetësime që janë duke u zgjidhur, që kanë nevojë për t'u zgjidhur, për t'u diskutuar, ky është një ndryshim që ne duam ta pranojmë si një arritje shumë të madhe.

Unë, si deputet i një zone rurale, si deputet i Belshit, një zonë ku bujqësia ka njohur dhe po njeh një zhvillim intensiv, kam një shqetësim, pasi gjithnjë dhe më shumë po konstatohet se po rritet numri i qytetarëve të Dumresë dhe të zonave të tjera që kthehen nga Greqia, ku kanë punuar prej vitesh dhe po krijojnë ato feramat e vogla, pra që po i kthehen bujqësisë. Kjo për faktin se më në fund ka një qeveri, që është kjo qeveri në mandatin e dytë dhe jo në të parin, që mendoj unë se e ka kthyer bujqësinë realisht në një prioritet të saj. Ka disa të dhëna që nga mënyra se si po investohet për qendrat e grumbullimit, "100 fshatrat" e të tjera, se po evidentohen gjithnjë e më shumë mungesat për agronomë, veterinerë dhe zooteknikë, nga ata me arsim të mesëm, por edhe nga ata me arsim të lartë. Janë mosha shumë të mëdha. Në zonën e Belshit të gjithë agronomët janë mbi 60 vjeç, aq më shumë që në bujqësi nuk mund të ecim pa standarde dhe standardet kërkojnë specialistë. Ka një shkollë të mesme bujqësore në Cërrik, por me sa kam parë unë, numri i nxënësve që frekuentojnë zooteknikën, agronominë dhe veterinarinë janë të paktë.

Unë ju ndoqa me vëmendje, por as te paraqitja juaj dhe as te materiali nuk kishte disa të dhëna. Pyetja është kjo: si është situata e përgatitjes së zooteknikëve, agronomëve dhe veterinerëve? Fjala është për bujqësinë, për një numër shumë të madh fermerësh, fshatarësh që po i kthehen këtij sektori.

Në orën 11:00 duhet të jem te paraqitja që bëhet sot nga grupi parlamentar për reformën zgjedhore, pasi jam anëtar i komisionit *ad-hoc*. Duket sikur nuk shkon nga pikëpamja etike të bësh pyetje dhe të ikësh. Por mendoj se kjo pyetje është përtej interesit tim. Unë do ta lexoj në procesverbal, por besoj se ata që na ndjekin përmes medias, kanë interes për këtë çështje, prandaj e bëra edhe unë pyetjen.

Milva Ekonomi - Fjala është për zonjën Rista. Më pas, fjala është për zonjën Xhembulla.

Adelina Rista - Faleminderit!

Dua t'ju falënderoj për prezencën tuaj dhe paraqitjen tepër serioze, që tregon përkushtimin tuaj!

Dua t'ju falënderoj ju edhe stafin tuaj që na dhatë një rezymë për arsimin dhe formimin profesional, për politikat e punësimit dhe të nxitjes së punësimit.

Unë në përgjithësi jam natyrë korrekte dhe dua t'i qëndroj konform rendit të ditës. Rendin e ditës sot e kemi: si filloi viti i ri mësimor në sistemin parauniversitar të arsimit profesional? Fillimin e vitit të ri mësimor, sot është e hëna e tretë që ka filluar ky vit mësimor, unë që e njoh mirë këtë profesion, arsimin, e lidh me të gjithë përgatitjen e infrastrukturës që duhet për ditën e parë të shkollës, që ajo të shkojë mbarë, si edhe në vazhdimësi për fillimin e vitit të ri mësimor. Përgatitja e infrastrukturës shkollë fillon që nga godinat shkollë, sa ishin gati për fillimin e vitit të ri mësimor, përgatitja e tyre, përgatitja e konvikteve, sepse shkollat profesionale kanë edhe një status të veçantë, disa janë me status rajonal, kanë konvikte. Kam një pyetje: si është lidhja me pushtetin vendor për përgatitjen e konvikteve? Si është përgatitja e stafit mësimor? A i kemi këto shkolla me një staf mësimor të plotë për fillimin e vitit të ri mësimor apo ka mangësi? A i kemi të gjitha shkollat, fëmijët të pajisur për ditën e parë të shkollës me tekste? A janë gati programet dhe planet mësimore nga të gjithë mësuesit dhe drejtoritë e shkollave? Kjo është infrastruktura për fillimin e mbarë të vitit të ri mësimor. Unë dua të di nga ju: si e kemi gjendjen sot, në të hënën e tretë, në javën e tretë të fillimit të shkollës në këtë drejtim për fillimin e mbarë të vitit të ri mësimor? A kemi ndonjë mangësi në ndonjë drejtim të caktuar nga këto që përmenda deri tani? Unë jam deputete e Fierit, ne në Fier kemi dy shkolla me emër, shkolla të mira, një me drejtim teknik dhe një tjetër me drejtim bujqësor, shkollën e mesme industriale "Petro Sota" dhe shkollën e mesme bujqësore "Rakip Kryeziu". Të dyja janë shkolla që kanë dhënë zë në Republikë për sa i përket përgatitjes së specialistëve sipas drejtimeve që ato kanë, njëra teknik dhe tjetra bujqësor.

Shkolla "Petro Sota" është një shkollë që filloi mbarë, sipas mendimit tim, qoftë me hapjen e klasave të para, qoftë me ato që ka futur në klasat e XII-ta, duke pasur parasysh kërkesën që ofron vetë rajoni që mbulon Fierin. Ka bashkëpunim me disa kompani private, kompani të fuqishme në Fier, siç janë: "Bankers", "Albstar", "TAP"-i e të tjera, pra duke u lidhur me këto kompani, se çfarë kërkojnë në klasën e XII-të, kjo shkollë ka futur disa tendenca për të ofruar degët që ka me ato që kërkon tregu. Kërkohet saldator? Atëherë nuk ka degë direkt për saldator, por në klasën e XII-të është futur pikërisht kjo degë, për t'u kualifikuar ata që do të mbarojnë edhe për saldator apo diçka tjetër.

Unë desha të dija prej jush, prandaj e preka një pak këtë. Si janë marrëdhëniet me kompanitë e fuqishme private, që operojnë nëpër qarqe apo që janë me zë edhe në gjithë Republikën: direkt shkolla apo nëpërmjet Ministrisë së Arsimit? Pra, cili është roli juaj në këtë pjesë?

Te fjala juaj më tërhoqi vëmendjen se 20 % e nxënësve që mbarojnë arsimin nëntëvjeçar i afrohen arsimit të mesëm profesional. Unë dua të di: sa nga ata që mbarojnë arsimin e mesëm profesional shkojnë në arsimin e lartë dhe sa shkojnë në tregun e punës? Sa janë të punësuar, nëse keni ndonjë statistikë? Sa janë të punësuar prej atyre që u afrohen tregut të punës dhe sa janë në pritje, nga këto shkolla të arsimit profesional? Sepse, në fund të fundit, qëllimi ky është: që ne të përgatisim punëtorë të kualifikuar, të specializuar në drejtime të caktuara, që ata ta gjejnë veten në tregun e punës. A i afrojnë ato kompani, te të cilat ata bëjnë praktikën profesionale?

Si jemi me kuadrin teknik, specialist? A kemi specialistë të kualifikuar për praktikat profesionale, në lidhje me ndërmarrjet ku operojnë, në shkollat tona profesionale? Pra, si jemi me kuadrin?

E fundit: në këto shkolla profesionale ka edhe kuadro që kanë qenë të punësuar me kontratë. Është fillimi i vitit mësimor. Si operoni ju me punonjësit me kontratë? Do të qëndrojnë me kontratë apo do t'u nënshtrohen konkurrimit, për të vazhduar më tej, për të hyrë në kuadrin e arsimit profesional?

Ju falënderoj!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Prit, se e ka fjalën Almira! Të lutem, se e kemi ndjekur rregullin shumë mirë deri tani. Të lutem!

Almira Xhembulla – Faleminderit, kryetare!

Faleminderit shumë, Dajna, për të gjithë prezantimin shterues! Në fakt, ndjehemi mirë kur shikojmë një panoramë goxha të mirë, goxha pozitive për sa i përket adresimit të arsimit dhe formimit profesional në shkallë vendi. E kemi ndjekur edhe në vijimësi. Patjetër, siç u theksua edhe nga kolegët, është një ndër ata sektorë, në të cilët me të vërtetë kemi bërë hapa përpara.

Pa rënë në përsëritje, sepse shumë nga pyetjet dhe shqetësimet tona të përbashkëta u shprehën nga kolegët, duke qenë se vi nga qarku i Dibrës, për të cilin ju keni informacion, ai qark vazhdon të mbetet një ndër ato me probleme më të mëdha ekonomike. Numri i të papunëve e ndërkohë edhe numri i përfituesve të ndihmës ekonomike, mbetet shumë i lartë.

Jo më kot, ditën e parë të vitit shkollor vizitova personalisht shkollën profesionale “Nazmi Rushiti”. Në fakt, aty kemi një ekip të mirë. Qoftë drejtuesit e shkollave, qoftë stafi akademik i shkollës kanë një performancë jashtëzakonisht të mirë dhe janë ndër mësuesit më të mirë që kemi, të themi të drejtën, po për fat të keq vura re këtë vit se numri nuk ishte ai që ne prisnim të gjithë.

Në komunikim me kolegët aty, me stafin akademik të shkollës, rezultoi se një ndër problemet kryesore ishte infrastruktura, mungesa e laboratorëve, por edhe çështjet që lidhen me praktikën. Kam përshtypjen se me gjithë problematikën që shoqëron qarkun, do të kërkoja pak më shumë vëmendje nga ana e qeverisë për sa i përket rajonit. Jam shumë dakord se shkollat profesionale të Lezhës apo të Shkodrës mund të zgjidhen nga nxënësit tanë, por kini parasysh se është rrugë katër-pesë orë, jashtëzakonisht e gjatë, jashtëzakonisht problematike, shtoj edhe nivelin ekonomik që kanë familjet.

Pa u ndalur shumë në gjërat e tjera, ne kemi qenë gjithmonë bashkë, në kontakte të vazhdueshme për sa i përket kësaj çështjeje, kështu që do të doja pak më shumë vëmendje, në kontakt edhe me donatorët, që të paraqitet si një ndër zonat që kanë realisht nevojë për mbështetje në këtë fushë.

Duke marrë shkas edhe nga ajo që tha Musai, ne po bëjmë shumë për sa i përket agroturizmit, përzgjedhjes dhe punës që po bëhet për fshatrat turistike atje. Kemi shumë potenciale, po mbështeten disa agropërpunuese dhe disa bujtina, por na duhet të fokusohemi shumë te zhvillimi i agroturizmit. Kemi shumë nevojë edhe për sa i përket sektorit agropyjor, por le të mos shkojmë direkt atje, por te teknologjia ushqimore dhe te ato gjëra të cilat ne mund t'i adresojmë.

Dua ta sjell edhe një herë në vëmendje se duhet ta kemi pak më shumë në konsideratë faktin se është dhe mbetet një qark ende problematik për sa i përket zhvillimit ekonomik.

Faleminderit!

Milva Ekonomi – Faleminderit, Almira!

Përpara se të fillonit shpjegimin, edhe unë do të doja të bëja nja dy-tri pyetje.

Së pari, Dajna, dua t'ju falënderoj juve personalisht dhe gjithë ekipin, që u treguat shumë të gatshëm sapo ju bëmë ftesën për të marrë pjesë në këtë dëgjësë.

Së dyti, dua të them se edhe për ne, arsimi profesional ka qenë në vëmendje, vëmendje që e kemi jo vetëm si deputetë të zonave prej nga vijmë, por edhe për të parë se si po shkon

programi qeverisës, sidomos në këtë sektor, i cili ka të bëjë me rritjen e mirëqenies së familjeve, duke sjellë punësim më të lartë.

Unë e dëgjova edhe shpjegimin që bëtë ju, por duke parë edhe listën e profesioneve kombëtare, kam nevojë të kem një sqarim: Sa punë ofrohen në Shqipëri, sa është gama e punëve që ofron Shqipëria?

Tani, në këtë komision, meqenëse kemi detyrimin të ndjekim edhe Ministrinë e Arsimit, kemi bërë disa diskutime. Diskutimi i parë ishte ai lidhur me kornizën shqiptare të kualifikimeve, që kaloi edhe si një ndryshim në Kuvend, ku morëm një vëmendje edhe për arsimin profesional. Si e shikoni ju veten në lidhje me këtë ndryshim që solli kurrikula kombëtare e kualifikimeve?

Pyetja e tretë lidhet me panairin e punës, i cili është zhvilluar në qytetin e Tiranës, ku për fatin tonë të mirë kishim disa folës. Midis folësve ishte zonja Nikolla, por dhe zoti Veliaj, si kryebashkiak i Tiranës. Aty lindi nevoja e një diskutimi në lidhje me kolegjet profesionale, për arsimin e lartë dyvjeçar profesional. Unë nuk e di sa jeni të informuar dhe se çfarë ka ndodhur në këtë sektor.

Gjëja tjetër që do të doja të ndaja me ju, është se të enjten e ardhshme, në Kuvend, ne si parlamentarë kemi diskutimin lidhur me buxhetin faktik të vitit 2017. A keni ju të dhëna, në lidhje me buxhetin faktik 2017 në sektorin e arsimit profesional, të cilat do të donit t'i ndanit me ne?

Shumë kolegë bënë pyetjen se si e shihni ju arsimin profesional në lidhje me punësimin. Në fakt, kjo është një pyetje e vërtetë, sepse lidhet me angazhimet që ka marrë qeveria në disa sektorë të rëndësishëm, siç është agroturizmi. Unë kam vënë re dy shkollat e formimit profesional që janë në Durrës, si dhe kam parë ecurinë e kurrikulave të tyre. Pashë se në shkollën “Hysen Çela” kualifikimi ose edukimi profesional që lidhej me peshkimin ka pasur vëmendje.

Ndërkohë, vura re se arsimi profesional që lidhej me peshkimin ishte një kurrikulë e shfaqur, e larguar, e rishfaqur. Kjo tregon se herë pas here është e nevojshme të flasim edhe me bizneset në lidhje me punonjësit e kualifikuar, që atyre u duhen në sektorët ku operojnë. Ndërkohë, aktualisht agroturizmi është një sektor i cili, në njëfarë mënyre, po zhvillohet, le të themi, me orientim dhe mbase nevoja e vërtetë nuk del në terren. A ka ndonjë strategji për të bërë harmonizimin midis dy qëllimeve: qëllimit të mirë që vjen nga programi dhe qëllimit zbatues në kurrikul?

Pyetja ime është se në diskutimet që kemi bërë për strategjinë e punësimit, kemi parë diçka shumë të rëndësishme, madje në Fier është ngritur çështja, lidhur me panairin e punësimit.

Sa shumë panairë punësimi bëhen në Shqipëri dhe sa panairët e punësimit orientojnë kërkesën për punë sipas qarqeve?

Në Fier kjo ishte një nevojë e madhe, sepse të rinjtë nuk janë aq mirë të informuar për sasinë e punëve që ofron Shqipëria.

A keni një plan për ta vazhduar panairin e punës në Shqipëri?

Faleminderit!

Dajna Sorensen – Do t’i bëj të grupuara përgjigjet, se janë shumë tema që u ngritën.

E para, inspektimi. Funkzioni i inspektimit në arsimin dhe formimin profesional në këtë moment është i munguar si funksion dhe është prioriteti ynë numër një. Përpara se të bëjmë çdo lloj reforme tjetër në arsimin dhe formimin profesional, futja e inspektimit në arsimin dhe formimin profesional është një domosdoshmëri.

Elementi i dytë që ka të bëjë, gjithashtu, me kuadrin institucional, që nga momenti i transferimit të këtyre shkollave nga Ministria e Arsimit, më pas te ish- Mirëqenia dhe sot te Ministria e Financave, ende mbeten në varësi të ministrisë në mënyrë të drejtpërdrejtë, me këndvështrimin që u përmend edhe më parë, që shkollat duhet të jenë shumë më tepër autonome.

Synimi ynë është që brenda gjysmës së parë të vitit 2019, ashtu sikurse u parashikua në ligjin “Për arsimin dhe formimin profesional”, menaxhimi nga ana administrative e shkollave do të kalojë pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit, pranë Agjencisë së re të Punësimit dhe të Aftësimit, që do të krijohet me ligjin e ri të nxitjes, që do të vijë shumë shpejt në tavolinat tuaja. Domethënë ky element është një domosdoshmëri dhe ne jemi duke e ndjekur me prioritet.

Po i marr tematikat e tjera një nga një. Për sa i përket orientimit të arsimit dhe formimit profesional, sipas nevojave të sektorit privat, po mundohem të përmbledh të gjitha pyetjet që kanë të bëjnë me sektorin privat në tërësi.

Në vitin 2017 ne ndërmorëm anketën e nevojave për aftësi, kur rreth 2560 ndërmarrje në vend u anketuan për nevojat që ato kanë për aftësi. Informacioni që ne kemi është shumë i detajuar në nivel lloji ndërmarrjesh: të vogla, të mesme, të mëdha, ndërmarrje shqiptare, me pronësi të huaj apo në bashkëpronësi.

Gjithashtu, i kemi të ndara sipas 4 rajoneve në Shqipëri, rajoni verior, juglindor, jugperëndimor dhe rajoni qendror, dhe kemi informacion të detajuar se çfarë mungesash në aftësi ka, cilët janë ata sektorë që kanë mungesa më të larta në aftësi dhe, mbi të gjitha, kemi edhe

informacion se çfarë parashikojnë kompanitë shqiptare për sa i përket rekrutimit të forcave të reja të punës.

Një element që ndoshta u përmend edhe në disa pyetje që u bënë, është se sa punë ka në Shqipëri, sa janë ndërmarrjet shqiptare neto, se gjithmonë në ndërmarrje ka hyrje dhe dalje në mënyrë të vazhdueshme.

Ndërmarrjet shqiptare neto, sipas analizës së nevojave për aftësi, dëshmuar se ato në vitin 2018 kishin rreth 39 mijë vende të reja pune, të cilat ata do t'i hapnin përtej stafit ekzistues, domethënë, mesatarisht në një vit; ne po flasim minimalisht për 30-35 mijë persona të rinj që mund të punësohen vetëm nga vendet e lira të reja që hap sektori privat.

Shërbimi Kombëtar i Punësimit bën një punë shumë aktive për sa i përket pjesës së identifikimit të vendeve të lira të punës pranë sektorit privat, sepse, në fund të fundit, ajo është oferta që u jepet të gjithë atyre që janë punëkërkuar të papunë.

Normal, ne raportojmë për këtë në mënyrë të përmuajshme, se sa janë vendet e lira të punës që janë të deklaruara pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Duhet të jemi koshientë për faktin se jo të gjithë bizneset vijnë te Shërbimi Kombëtar i Punësimit për të deklaruar vendet e lira, por ne variojmë te 5000-6000 vende të reja pune mesatarisht çdo muaj.

SHKP-ja ka pasur objektiv për vitin 2018 që, minimalisht, të identifikonte, të paktën, 40 mijë vende të reja pune pranë bizneseve. Ky objektiv tashmë është arritur. Aktualisht, jemi te niveli mbi 50 mijë vende pune, të cilat janë të identifikuara gjatë gjithë vitit.

Në qoftë se hyni te portali i SHKP-së, ku jo të gjitha vendet e lira të punës janë të deklaruara *online*, një pjesë e bizneseve preferojnë të mos i kenë të deklaruara *online*; në çdo moment *online* mund të jenë 3 mijë apo 4 mijë, kurse një pjesë tjetër ndodhet pranë zyrave të punës, domethënë se hapësirë dhe kërkesë nga sektori privat për forcë pune të kualifikuar ka me shumicë.

Një tjetër element, që është shumë i rëndësishëm, janë investitorët e huaj. Ne shpeshherë themi se sa investitorë të mundshëm jemi duke humbur. Kjo ndodh sepse nuk kemi forcat e punës të kualifikuara dhe këtë nuk jemi në gjendje ta masim, prandaj është shumë e rëndësishme që anketa, si: Analiza e nevojave për aftësi, që u bë në vitin 2017, të përsëritet në mënyrë periodike, që të informojë jo vetëm zyrat e punës për atë që po kërkon tregu, por mbi të gjitha të orientojë arsimin dhe formimin profesional, më tepër kurset afatshkurta, meqenëse ne duam t'u përgjigjemi

nevojave të biznesit sot, jo si në rastin e arsimit profesional, ku një kthesë që ti e merr sot, rezultatet i ka pas 4 vjetësh.

Duke qëndruar sërish te sektori privat, u përmend në disa raste çështja e praktikave profesionale. Praktikantët profesionale pranë ndërmarrjeve janë shumë të mira. Ne kemi shkollat dhe drejtues apo mësues shkollash, të cilët janë super të angazhuar për të identifikuar pranë sektorit privat, vende ku nxënësit mund të kryejnë praktika profesionale dhe po flasim për praktika profesionale jo vetëm një muaj në vit, por po flasim për praktika profesionale afatgjata, ku nxënësit në mënyrë të vazhdueshme mund të shkojnë pranë këtyre bizneseve për 1, 2 apo 3 orë në ditë, në varësi të llojit të biznesit për të bërë një praktikë pune afatgjatë.

Problemi më i madh që kemi në lidhje me këtë është fakti që ky lloj bashkëpunimi me sektorin privat mbetet ende sporadik dhe nuk është në nivel sistemi.

Ne kemi shkollat në Vlorë, në Lezhë, në Korçë, në Shkodër, në Tiranë e në të tjera qytete, të cilat janë shumë të afta për t'iu afruar sektorit privat dhe për t'i tërhequr nxënësit të lidhin kontratat të mirëfillta të të nxënësve nëpërmjet punës, por ato janë raste sporadike dhe nuk i kemi të gjitha në nivel sistemi.

Sfida jonë është që ato praktika të mira që herë i kemi pasur me donatorë, herë i kemi pasur edhe vetë, t'i ngremë në nivel sistemi.

U përmend në një moment edhe çështja e një modeli të teknikave profesionale. Është shumë e vërtetë. Edhe në tryeza me donatorë të ndryshëm ne kemi folur në mënyrë të vazhdueshme për modelin gjerman, austriak, italian e të tjera, por ka ardhur momenti që të mos flasim më domosdoshmërisht për modele të tjera, por kemi mjaftueshëm praktika të mira në këtë vend për të filluar të flasim për modelin shqiptar.

Prandaj, një nga aktet nënligjore, që ka të bëjë me arsimin dhe formimin profesional, ka të bëjë pikërisht me rregullimin e praktikave të punës pranë ndërmarrjeve.

E them këtë, sepse ka dy anë të kësaj medaljeje: nga njëra anë ne duam që nxënësit tanë të kenë akses dhe të shohin çfarë ka në sektorin privat, dhe të mësojnë nga risitë në sektorin privat, por, nga ana tjetër, do të kemi sigurinë që, së pari, nuk shfrytëzohen dhe, së dyti, dhe shumë i rëndësishëm, është fakti që nëpërmjet punës kontribuon realisht në ato elemente, të cilat janë brenda kurrikulave të tyre dhe kanë një kontribut real drejt tyre. Stavri ndoshta mund ta sqarojë më mirë këtë pjesë.

Për sa u përket investimeve kapitale dhe buxhetit faktik, unë mund t'ju jap disa shifra, të cilat mund t'ju dërgoj edhe me shkrim, pak më të detajuara.

Unë mund t'ju përmend disa nga investimet e ndërmarra në shkolla gjatë vitit 2017, të cilat janë: “Karl Gega” rreth 156 milionë lekë, Shkolla e Mesme Profesionale e Kamzës 213 milionë lekë, “Ali Myftiu” Elbasan 97,9 milionë lekë, “Petro Sota” Fier 94 milionë lekë, “Kristo Isaku” Berat 73,7 milionë lekë, “Beqir Çela” Durrës 231 milionë lekë, “Arben Broci” Shkodër 181 milionë lekë, në fazë prokurimi është dega Hoteleri-Turizëm në Tiranë, me rreth 100 milionë lekë dhe “Gjergji Canco” në Tiranë, 323 milionë lekë të parashikuar për ndërtimin e kësaj shkolle.

Për sa i përket buxhetit faktik të parashikuar për vitin 2017, ka qenë rreth 3 miliardë lekë, të cilin e kemi shumë të detajuar sipas institucioneve dhe do t'ua dërgojmë. Buxheti i parashikuar për vitin 2019 mendojmë se do të ketë një rritje modeste mbi këtë shifër.

Stavri Lako - Investimet, pagat dhe sigurimet janë planifikuar sipas kërkesave të shkollave, por edhe shpenzimet operative nëpër shkolla kanë vështirësi. Ata kanë progresuar dhe janë ndërgjegjësuar se duhet ta shpenzojnë atë buxhet që u akordohet, sepse ndikon pozitivisht në cilësinë e mësimdhënies. Më vonë mund t'ju dërgojmë informacionin.

Dajna Sorensen – Një tjetër çështje që u ngrit kishte të bënte me cilësinë e mësuesve dhe drejtuesve në shkollat profesionale dhe portalin.

Gjatë këtyre viteve ka pasur rekrutime, shpeshherë me kontrata afatshkurtra, të cilat gradualisht dhe duke u përsëritur çdo vit kanë rezultuar në mësues definitivë. Qasja jonë ndaj kësaj është që të formalizojmë procesin në mënyrë rigorozë. Domosdoshmërisht mësuesit e lëndëve të përgjithshme duhet të rekrutohen nëpërmjet portalit. Kjo është qasja jonë lidhur me to.

Për sa i përket rritjes së kapaciteteve të mësuesve, unë e përmenda edhe më parë që trajnimi i vazhdueshëm është një domosdoshmëri, sidomos i mësuesve të lëndëve profesionale, dhe për këtë ka filluar trajnimi i parë 24-ditor, i cili ka të bëjë me bazat e didaktikës.

Për sa u përket nxënësve, të cilët vijnë nga zonat rurale, është një çështje që u ngrit disa herë. Si incentivë në vetvete për të afruar arsimin dhe formimin profesional pranë zonave rurale kanë qenë pikërisht bursat që këta studentë kanë marrë. Aktualisht, numri i personave, të cilët vijnë nga zonat rurale dhe ndjekin arsimin profesional ka arritur në 40%.

Stavri Lako – Më shumë sesa kjo është stimulimi që ne u bëjmë individëve, sidomos nga zonat rurale, duke u akorduar bursa. Numri i bursave të akorduara nga institucionet përgjegjëse për arsimin ka ardhur gjithmonë në rritje, nga 1800 në 2100. Aktualisht jemi në fazën e bërjes,

sepse VKM-ja e bursave bëhet çdo vit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe përfshin të gjithë arsimin, duke filluar nga arsimi bazë deri tek arsimi universitar dhe ne japim kontributin tonë. Numri i bursave ka ardhur duke u rritur dhe fondi po ashtu.

Ne kemi specifikuar drejtime, të cilat, siç i përmendi edhe zoti Ulqini, janë më pak të frekuentuara dhe për t'i motivuar e nxitur nxënësit që të ndjekin degët, si bujqësia, veterinaria dhe ato që përmendi zotëria, siç janë gjeologji - minierash, naftë e të tjerë kemi menduar që këtë vit të ngushtojmë hendekun, që shefja e përmendi, në punësim. Po t'u referohemi edhe drejtimeve në shkolla, ka disa degë që ndiqen nga vajzat dhe disa nga djemtë. Ne jemi konsultuar dhe na kanë thënë se mund ta vëmë, që të stimulojmë pjesëmarrjen e vajzave në degët që aktualisht ato nuk i frekuentojnë.

Vlera e shumës që akordohet për bursat është 210 milionë lekë të rinj.

Dajna Sorensen – Ka pasur një sërë studimesh nga partnerët tanë ndërkombëtare, duke filluar që nga vitet '90 deri më sot, të cilët në mënyrë të vazhdueshme thonë: “Ne kemi nevojë për një konsolidim të ofertës së arsimit dhe formimit profesional”. Arsimi dhe formimi profesional është i kushtueshëm dhe nuk mund të kemi të njëjtat degë, që ofrohen në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha shkollat, në nivel kombëtar, por në disa sektorë të caktuar mund të kemi qendra, që ne i quajmë qendra multifunksionale, të cilat mund të ofrojnë një gjë të tillë. Ne kemi shkolla profesionale, që variojnë nga 75 nxënës në 1500, 2000 nxënës. Shembull konkret është Shkolla Profesionale e Kamzës, e cila ka 1800 nxënës, ku, në vetvete, niveli nuk mund të jetë njëlloj dhe duhet ngritur një pikëpyetje për qëndrueshmërinë e një shkolle të tillë.

Ne po ndërmarrim riorganizimin e ofruesve në qendra multifunksionale. Në rastin e Vlorës, *setup-i* është shumë i thjeshtë, sepse ka dy shkolla dhe një qendër të formimit profesional, ku të tria së bashku mund të funksionojnë si një qendër multifunksionale.

Për sa u përket shkollave bujqësore, një nga modelet dhe një nga mundësitë që ne po shikojmë është që të kemi tri shkolla bujqësore në të gjithë Shqipërinë: një në veri, një në zonën e Myzeqesë, pa e specifikuar se ku, dhe një diku afër Cërrikut. Domethënë, po shohim disa mundësi, por duhet të kemi tri alternativa, në mënyrë që të mos hallakatemi në 125 shkolla pa ofruar diçka cilësore.

Kishte një pyetje konkrete nga zoti Ulqini për sa i përket numrit të nxënësve, që kemi aktualisht në bujqësi dhe veterinari dhe numri mbetet i ulët.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po flasim vetëm për regjistrimet e reja. Në total kemi pasur 291 regjistrime të reja në bujqësi dhe veterinari, të kombinuara së bashku.

Zoti Nasufi, përmendi faktin se në Berat, te shkolla “Kristo Isak”, nuk ka pasur ofertë të re për sa i përket bujqësisë. Kjo varet shumë edhe nga interesi i të rinjve dhe të rejave. Maksimumi që mund të bëjmë është t’jua ofrojmë, por nuk i detyrojmë dot domosdoshmërisht që të ndjekin kurse profesionale apo shkolla profesionale në një drejtim apo në një tjetër. Maksimumi që mund të bëjmë është promovimi i tyre.

Për sa u përket projeksioneve për zonat mineralmbajtëse, këtu mund të më ndihmojë zoti Stavri.

Stavri Lako – Normalisht, ne kemi vetëm dy degë që ofrojmë: kemi degën shpim - kërkim, naftë-gaz në shkollën “Petro Sota” në Fier dhe degën gjeologji- miniera në Bulqizë, që është një degë e shkollës së Dibrës; e kemi vendosur dhe shumë shpejt do të unifikohen. Për momentin vetëm për këto dy degë. Vërejtja është me vend dhe do ta shikojmë me precedencë në të ardhme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Unë e mirëkuptoj atë, sepse në zonën që përfaqësohet është në rregull në lidhje me shkollat profesionale, mekanike dhe bujqësore. Ndërsa ky shqetësim është real dhe jua thashë këtë edhe për shkak të zbatimit të statusit të naftëtarëve.

Jam inxhinier në profesion, kam punuar në këtë industri dhe e shikoj me shumë dhembshuri. Industria e naftës dhe e gazit është një industri e përbërë nga poliprofesione, nuk ka vetëm gjeologë, nuk ka vetëm gjeodetë, nuk ka vetëm inxhinierë të naftës dhe të gazit, por është edhe industria e përpunimit, që është një nga sektorët shumë të rëndësishëm. Këtyre dy shkollave që ju përmendët në Fier, që “Petro Sota” e ka futur si degë, ia kam bërë unë kurrikulën e shkollës profesionale dhe e di se çfarë programi ka dhe sa e mbështet profesionalisht me specialistë të mesëm të kualifikuar gjithë këtë industri naftë. Aktualisht që po flas janë mbi 2 mijë punonjës vetëm në kompaninë publike “Albpetrol”. Po tek “Albgazi” që ne kemi edhe strategjinë e gazifikimit të Shqipërisë, përveç transportit të gazit, po në industrinë e kërkimit dhe të shpimit, po të prodhimit të naftës? Me keqardhje shprehem: po e mban brezi...

Milva Ekonomi – Zoti Beqiraj, kishit një diskutim të shkurtër.

Ismet Beqiraj – Të lutem, sepse e kam ngritur disa herë këtë shqetësim dhe tani është viti i dytë i përfaqësimit tim si deputet në këtë zonë dhe nuk duhet t’i rrumbullakosim problemet.

Jam plotësisht dakord me zhvillimin dhe me hapin që ka marrë, por në kushtet që ne kërkojmë, nga njëra anë, implementimin e statusit të naftëtarit, dhe është një numër i konsiderueshëm që del menjëherë nga puna, janë gati 2 mijë punonjës të sistemit të naftës, për shembull, ai saldatori që thatë më parë, nuk bëhet saldator për një ditë, do të paktën 15-20 vjet eksperiencë, nuk bëhen teknologë, kryesondistë të përpunojnë naftën.

Ju lutem, unë këtë gjë do ta kërkoj edhe gjatë diskutimit të projektbuxhetit, por të ketë një projeksion të saktë për këtë industri. Në qoftë se duam ta falimentojmë me indiferencën tonë, le ta falimentojmë. Ajo do të falimentojë jo se nuk ka burime natyrore, por sepse nuk ka njerëz që ta drejtojnë dhe ta mbajnë në këmbë. Ky është një nga sektorët që këta 27 vjet nuk ka falimentuar, por i ka dhënë kontribut buxhetit të shtetit. Të gjitha u shkatërruan.

Milva Ekonomi – E morën shënim dhe do ta ngrenë te diskutimet që kanë për të bërë.

Ismet Beqiraj – Të lutem, duhet ta ngremë në seancë dhe jo vetëm ta marrin shënim. Unë këtë punë e kam shqetësim!

Milva Ekonomi – Mandati i deputetit të jep të drejtën të shkosh të kontrollosh se çfarë bën “Albpetroli”. A ka një shkollë profesionale brenda ndërmarrjes?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

I themi Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin që të bëjmë një kontroll.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Natyrisht, mbase ata nuk kanë nevojë për këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ndërkohë, mund të bëjmë një vizitë të përbashkët.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Beqiraj, nuk është kështu. Hajdeni të bëjmë një vizitë.

Ismet Beqiraj – Të lutem, zonja Milva, jam pedagog në Fakultetin e Shkencave. Rropatemi për t’i çuar studentët atje, vetëm me miq dhe po u deshi qejfi atyre. Çfarë është kjo?!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – E shënuam shqetësimin tënd, do të flasim me Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin që të bëjmë një nismë ligjore ose të shkojmë dhe ta shikojmë në vend.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem, zoti Ismet, të lëmë zonjën Dajna të vazhdojë, sepse kjo gjë nuk është për këta. Çështja e arsimit profesional nuk është tani, tani jemi me arsimin parauniversitar.

Ismet Beqiraj – Unë mbaj shënime dhe këto shënime nuk i mbaj kot. Të nxjerr shënimet e para një viti ose kur kemi bërë seancë dëgjimore për arsimin profesional, hapni procesverbalin dhe lexoni mendimin tim.

Milva Ekonomi – Procesverbalin e kam përpara.

Ismet Beqiraj – Mos t'i kthejmë kurrizin këtij sektori.

Milva Ekonomi - Në rregull.

Urdhëroni, zonja Sorensen!

Dajna Sorensen – Ne jemi të gatshëm për çdo gjë. Në qoftë se ka kërkesë nga nxënës, të cilët janë të gatshëm të shkojnë në sektorë të caktuar, ne kemi qenë të gatshëm...

(Zoti Beqiraj flet pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Të lutem, lëre zëvendësministren të vazhdojë.

Dajna Sorensen – Për sa i përket sistemit të gjurmimit, është një pyetje që doli në mënyrë të vazhdueshme: çfarë ndodh me nxënësit të cilët mbarojnë arsimin e mesëm profesional? Dua të them se për herë të parë jemi duke implementuar një sistem gjurmimi, jemi duke ndjekur se çfarë ndodh me nxënësit e arsimit profesional. Ne bëmë një pyetësor për ata që u diplomuan në gusht të vitit 2017 dhe ndoshta zonja Etleva Gjellaj mund të na japë pak më shumë informacion se çfarë thotë sistemi i gjurmimit. Një shifër të saktë që mund të jap tani në këtë moment është se 47% e atyre, të cilët u diplomuan nga arsimi profesional në vitin 2017, janë të punësuar. Ndërsa përsa i përket pyetjes se sa janë në arsim, ndoshta zonja Gjellaj ka më shumë informacion për këtë gjë.

Etleva Gjellaj – Përshëndetje!

Ashtu siç e tha edhe zonja zëvendësministre, për herë të parë Shërbimi Kombëtar i Punësimit ka ngritur një sistem për të gjurmuar, pas përfundimit të arsimit apo formimit profesional, të gjithë studentët apo kursantët që kanë përfunduar në punësim. Pra, ka nivelin e punësueshmërisë së tyre pas përfundimit të arsimit apo formimit profesional. Niveli i përgjigjes ka qenë gati 20%, që do të thotë një nivel i kënaqshëm për të thënë se këto shifra janë shumë afër realitetit. Ne e kemi shumë të vështirë të gjurmojmë punësimin pas përfundimit të arsimit dhe formimit profesional nëpërmjet sistemit të tatimeve, duke menduar që një pjesë e këtyre nxënësve apo kursantëve edhe vetëpunësohen, duke parë edhe nivelin e informalitetit, i cili sidomos në vetëpunësim është më i lartë se në përgjithësi dhe duke qenë se kurset profesionale të ofruara në

sistemin e formimit profesional, janë kryesisht kurse për vetëpunësim më shumë se kurse për punësim në industri apo në ndërmarrje, të cilat tashmë operojnë në shumë fusha në vend. Për këtë arsye menduam se ngritja e një sistemi gjurmimin nëpërmjet pyetësorëve apo anketës, është një sistem që na ofron shumë më tepër në realitet për sa i përket nivelit të punësimit pas përfundimit të kurseve. Ky nivel mat efikasitetin e gjithë sistemit tonë të arsimit dhe formimit profesional. Ashtu siç tha Dajna, niveli këtë vit ka qenë 47% për shkollat profesionale, ndërsa për qendrat e formimit profesional ka qenë 41%, një nivel që është edhe një nga objektivat e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, pra që 40% e të gjithë të dërguarve në formimin profesional nga listat tona të punëkërkuesve të papunë të arrijnë të punësohen pas përfundimit të këtij kursi. Ky ishte bërë për herë të parë dhe është pilot, por është një proces që do ta bëjmë në vazhdimësi dhe parashikohet që deri në mars të vitit 2019 ne të kemi raportin e radhës, që është edhe një nga treguesit e mbështetjes buxhetore, një tregues që është realizuar për vitin që kaloi. Raporti i vitit 2019 do të përmbajë gjurmimin e të gjithë nxënësve që kanë përfunduar sistemin e arsimit profesional gjatë periudhës së vitit 2017-2018 dhe të të gjithë kursantëve të qendrave të formimit profesional, të cilët kanë përfunduar të paktën një kurs formimi gjatë gjithë vitit 2018. Ky raport do të na japë mundësinë, sepse tashmë ne e kemi një shifër, që të kemi ku të referohemi dhe të matim edhe rritjen apo ecurinë e sistemit të AFP-së në një vit pasardhës, duke qenë se ishte për herë të parë dhe ne nuk kishim një *baseline* për ta filluar dhe për të pasur krahasueshmëri për të matur nivelin e rritjes apo impaktin e gjithë këtyre ndërhyrjeve që janë bërë në sistemin e AFP-së.

Dajna Sorensen – Bujari kishte një pyetje konkrete për sa i përket shkollës mekanike bujqësore...

Milva Ekonomi – T’ju ndërpres një minutë, se kërkon zonja Rista një shpjegim?

Adelina Rista – Unë mendoj se për këtë, të cilën sapo ju e shpjeguat shumë mirë, duhet t’i vendoset përgjegjësi shkollës nga ku ka dalë si nxënës, që nesër të më shërbejë edhe mua si shkollë për kartën time të performancës. Unë si shkollë, si mësuese dua ta ndjek nxënësin tim se ku shkon, pra pasi mbaroi tek unë, ku shkoi ai? Në qoftë se ne krijojmë këtë lidhje me shkollën vitin e parë, shkolla duhet t’i ndjekë, që t’i ofrohen tregut të punës në kompani private, ku bëjnë praktikën profesionale apo në kompanitë shtetërore. Pra, këtë shkuan në arsim të lartë, këta të tjerët i kam këtu gjendje. Domethënë, kjo i shërben edhe shkollës për rritjen e performancës së saj, pra për të thënë që nga bankat e shkollës kanë dalë kaq këtu, kaq atje etj.. Kjo duhet t’i vihet përgjegjësi shkollës.

Faleminderit!

Etleva Gjelaj – Në vazhdim të kësaj që sapo ju përmendët, një nga risitë e ligjit të ri “Për arsimin dhe formimin profesional”, i miratuar në vitin 2017, është krijimi i njësive zhvillimore në çdo njësi ofruese të arsimit dhe formimit profesional. Njësia zhvillimore është në fazën e krijimit. Nuk mund ta kërkojmë impaktin e një njësie që deri dje ishte në formë jointitucionale dhe tashmë po kërkohet me ngulm të ketë formën e saj institucionale, që çdo qendër apo shkollë e arsimit apo formimit profesional të ketë brenda saj njësinë zhvillimore, në funksionet e së cilës futet lidhja me biznesin, me zyrat e punësimit, zhvillimi i karrierës. Zhvillimi i kurrikulave dhe programeve mësimore brenda qendrës apo shkollës së arsimit dhe formimit profesional janë elemente shumë të rëndësishme, që bëjnë pikërisht këtë gjë. Duke institucionalizuar një njësi që do të merret dhe ka përgjegjshmëri vetëm për këtë gjë, i jepet rëndësi vetë shkollës, sepse kjo marrëdhënie është shumë e rëndësishme për të gjithë aktivitetin.

Milva Ekonomi – A mund të them diçka të rëndësishme për ta kuptuar edhe ne?

Unë kam përshtypjen se nuk funksionon më tregu i punës me këto ndjekje, sepse ato janë ndjekje në sistemin e planifikimit. Ne kemi hequr dorë nga sistemi i planifikimit dhe jemi në ekonominë e tregut prej shumë vjetësh. Unë me numër amze dhe me numër ID-je i kam detyrat dhe përgjegjësitë institucionale të ndara. Njëri me bën vaksinat, njëri më ofron arsimin bazë, unë ndjek arsimin e lartë, pastaj shkoj në punë, ku është përgjegjësia ime dhe e atij që më merr në punë. Ne në Shqipëri duhet të ngremë disa sisteme që janë gjithmonë të diskutueshme, nëse duhet të jenë në territor apo jo. Po përpiqemi të krijojmë sisteme për ato që janë shërbime bazë, për të cilat ka detyrim shteti, ndërsa punësimi nuk është detyrë e shtetit, por është edhe përgjegjësi individuale. Prandaj është shumë e rëndësishme të kuptojmë ndarjet e mëdha që po ndodhin. Ne po rregullojmë shërbimet. Po të duan, regjistrohen të *site*-i, po të mos duan, nuk regjistrohen. Shqipëria po përpiqet të të lërë të drejtën e zgjedhjes. Individit e zgjedh tregun e punës, shteti e ka për detyrë të ofrojë shërbimet që i cakton Kushtetuta dhe këto duhet t'i ndjekë. Kështu, kjo është shumë e drejtë, por duhet të kemi parasysh edhe pjesën e funksionimit të sistemeve, të cilat janë në letër, por janë edhe sisteme IT-je.

Dajna Sorensen – Bashkëndaj të njëjtin mendim me ju 100%.

Pyetjet e tjera do t'i kalojmë pak më shpejt. Bujari kishte një pyetje për shkollën mekanike bujqësore në Lushnje.

Po, do të vazhdojë të mbështetet, është e parashikuar në kuadër të marrëveshjes me Italinë, me qeverinë italiane për një shkollë multifunksionale. Pra, është një projekt që do ta mbështesë këtë shkollë.

Një pjesë të pyetjeve të Vilmës i cekëm. Për hendekun gjinor në punësim dhe çfarë praktikash dhe strategjish jemi duke ndjekur, ne dimë një gjë: në rastin e femrave, kur ato zgjedhin të jenë pjesë e tregut të punës, janë faktikisht më të punësueshme se meshkujt. Domethënë, problematikën më të madhe për sa i përket punësimit të femrave e kemi ekskluzivisht te pjesëmarrja në tregun e punës, që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me shërbimet e kujdesit të fëmijëve dhe me transportin dhe largësinë e shtëpive të tyre nga vendi i punës. Jemi duke i adresuar këto. Dy elemente do t'i shikoni edhe te ligji i ri i nxitjes së punësimit, të cilat po mundohemi t'i integrojmë në atë ligj, që të mundësojmë edhe subvencionimin e kostove të transportit dhe të shikojmë incentiva të mundshme për të rritur pjesëmarrjen e grave në forcat e punës.

Sa shkolla kanë përfituar nga donatorët?! Aktualisht, gjysma e shkollave kanë përfituar në një mënyrë ose në një tjetër nga donatorët. Megjithatë, duhet të jeni koshtentë për faktin që mbështetja e donatorëve nuk do të jetë pa fund. Tani është detyra jonë dhe topi është komplet në fushën tonë që të sigurohemi që ato praktika të mira që kemi me donatorët, t'i ngremë në nivel sistemi.

U përmend këtu pak më parë edhe pjesa e gjurmimit dhe e cilësisë. Vilma përmendi nëse ka një rankim të shkollave. Vlerësimi i fundit i jashtëm i ofruesve të arsimit profesional është bërë në vitin 2014, ku kemi një rankim të shkollave me 1, 2 ose 3 yje. Në Shqipëri në atë periudhë kishim vetëm një shkollë me 3 yje dhe kjo ishte "Beqir Çela" në Durrës. Kemi një seri shkollash me 2 yje dhe plot shkolla me 1 yll. Që nga ai moment, ka pasur një ndryshim rrënjësor të një numri të madh të këtyre shkollave. Kjo do të thotë që në kuadër të garantimit të cilësisë për arsimin dhe për formimin profesional, jemi duke ndërmarrë hapin e parë të garantimit të cilësisë, që është vetëvlerësimi i ofruesve të arsimit dhe të formimit profesional. Ata po e vlerësojnë veten në 10 kategori të ndryshme, përfshirë këtu edhe efektivitetin e tyre në lidhje me tregun e punës apo punësueshmërinë e këtyre individëve. Ata po e bëjnë këtë proces vlerësimi në të dhjetë kategoritë. Pas mbylljes së këtij viti akademik, ne do të kemi një rirankim të ofruesve. Gjithmonë nga këndvështrimi ynë, jo domosdoshmërisht për t'i afruar ofruesit me njëri-tjetrin, më tepër sesa një *benchmarking*, që ata bëjnë për performancën e tyre të mëparshme.

Ju kishit edhe pyetjen: sa kompani janë të gatshme për të pritur praktikant profesional? Realisht kjo varion nga shkolla në shkollë. Kemi raste shumë të mira, si në rastin e Gentit të shkollës “Pavarësia”, kemi edhe raste të tjera, ku praktikant profesional nuk janë efektive, por janë më shumë në letër.

Zoti Fate përmendi rastin e saldatorëve. Unë do ta sillja diskutimin te fakti që këtu kemi më shumë ofrues publikë, si shkollat dhe qendrat, por kemi edhe shumë ofrues privatë për formimin profesional në veçanti, sidomos për kurse për saldator, elektrikist etj..

Ne nuk duhet ta shohim ofertën për arsimin dhe formimin profesional të kufizuar vetëm te ofruesit publikë. Nëse ka një ofrues privat, i cili mund të kualifikojë një person, ndoshta edhe më mirë sesa ofruesit publikë, ne duhet ta hapim këtë rrugë, sepse nuk mund të presim të rritet performanca e shkollave dhe e qendrave, derisa këta njerëz të jenë të kualifikuar profesionalisht në një drejtim ose në një tjetër.

Në këtë fundjavë, pata mundësinë të shkoj në një nga qendrat private, në të cilën kishte saldatorë që mund të kishin stazh pune 20-30 vjeçar dhe shkonin aty për të marrë një nivel më të lartë certifikimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Japin certifikata, madje edhe ndërkombëtare në disa raste. Në rastin konkret, bëhej fjalë për wi-fi dhe vetë kompania austriake vinte dhe bënte vlerësimin e atyre saldatorëve, për të pasur atë nivel të caktuar kualifikimi, i cili ishte i njohur ndërkombëtarisht. Pra, ka shumë ecuri në treg dhe nuk mund të presim domosdoshmërisht ofruesit publikë, por duhet të hapim rrugën edhe ndaj këtyre ofruesve privatë, që ofrojnë edhe kualifikime, të cilat janë të njohura ndërkombëtarisht.

Megjithatë, edhe nga shkollat tona, po marr rastin e Vlorës, se e njoh mjaft mirë, ka disa nga nxënësit që kanë mbaruar shkollën “Pavarësia”, diplomat e të cilëve në fushat respektive janë njohur jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë saj.

Etleva Gjellaj – E kemi diskutuar edhe një herë çështjen e qendrave të formimit profesional. Siç u tha në këtë takim, edhe në tryezë, dhe nga të gjitha shqetësimet që ju ngritët, janë shumë të rëndësishme forcimi i kurrikulës, i mësimdhënies, i instruktorëve, cilësia e laboratorëve, e infrastrukturës, pjesa e zbatimit të praktikës në biznes. Të gjitha këto bëjnë që të kemi një formim të mirë profesional, që nxjerr persona të mirëformuar dhe ne jemi duke u përprjekur në të gjitha këto drejtime. Një nga këto është edhe cilësia e instruktorëve.

Kemi diskutuar bashkë edhe një rast në Vlorë. Është shumë i rëndësishëm roli që instruktori ka për zanate të caktuara, si të thuash ka dy nivele të përzgjedhjes: 1. Nga shkollat e mesme profesionale me kategoritë përkatëse për zanatin;

2. Ka edhe me arsim të lartë.

Këto janë specifikuar në bazën ligjore. Ne e kemi përforcuar shumë këtë sistem, pikërisht për të përzgjedhur instruktorët më të mirë në treg jo vetëm nga aftësia, por edhe nga aftësia e mësimdhënies së tyre. Ky është një hap shumë i rëndësishëm, të cilit ne i kushtojmë shumë vëmendje. Të paktën për këtë vit ne jemi treguar maksimalisht të rreptë në Shërbimin Kombëtar të Punësimit për ta përforcuar sistemin e mësimdhënies.

Të njëjtën gjë po bëjmë edhe me sistemin e kurrikulës, të cilin po e përforcojmë duke i rishikuar kurrikulat me Agjencinë Kombëtare të Rishikimit të Kurrikulave. Është e vetmja mënyrë që ai që do të dalë me titullin “saldator”, ta meritojë këtë titull. Po flas të paktën për formimin profesional.

Dajna Sorensen – Tani të kthehemi te pyetja e Adelinës, se sa të përgatitur ishim ne për fillimin e vitit të ri shkollor. Jo, nuk ishim të përgatitur 100% ashtu siç duhej. Disa elementeve u patëm paraprirë me shkollat, duke u munduar t’i përgatisnin para se të fillonte viti akademik. Megjithatë, përsëri sot kemi shkolla që kanë mungesa në stafin mësimor. Nga ana e infrastrukturës në shumicën e rasteve kemi qenë të përgatitur, me disa mungesa të vogla në disa shkolla.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pajisjen me staf mësimor po e trajtojmë me prioritet, të paktën në ato shkolla ku ka pasur mungesa, edhe për shkakun se në këto shkolla pati një fluks shumë të madh dhe të paparashikuar nxënësish nga sa patëm presupozuar se do të kishim. Po përpiqemi që ato shkolla t’i pajisim me staf mësuesish sa më shpejt që të jetë e mundur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Stavri Lako – Në momentin që shkolla kaloi nën varësinë e ish-ministrit, u hoq statusi i shkollave...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po. Janë që të gjitha.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pati me të drejtë disa shqetësime për konviktet nga disa deputetë. Kjo është pika jonë e dobët. Ne do të pranohim me kënaqësi që t’i menaxhoni vetë konviktet. Kam përshtypjen se

është pak e vështirë, sepse është një kompetencë e deleguar te pushteti vendor dhe për t'ia marrë duhet...

Ne vazhdimisht kemi pasur probleme. Unë nuk dua të zgjatem, por po të shkosh në shkollën e Shkodrës, është një absurd. Janë dy konvikte, ekzistuesi dhe i ri, i cili përdoret si magazinë, megjithëse është një godinë shumë e mirë. Ndërkohë, edhe i vjetri nuk është i keq. Gjysma e tij është e zënë, ashtu siç qenë zënë edhe shkollat e Tiranës. Pra, ne me kënaqësi do t'i merrnim vetë, sepse është një element, i cili ndikon pozitivisht. Duke qenë se shkollat janë kombëtare, do të rritej mundësia për akomodim.

Vërejtja e zotit Fadil është me vend, sepse shumë nga ato po degradojnë, por siç thashë, ajo është kompetencë e bashkisë.

Fadil Nasufi - Një koment të shkurtër, se e kam nga përvoja në Berat. Bashkia e Beratit po operon që ta japë me qira godinën me kontratën e emfiteozës. Njërin e ka dhënë dhe e ka futur dy herë në mbledhjen e këshillit.

Unë i njoh mirë ligjet, si atë për PPP-të, për koncesionet dhe për kontratën e emfiteozës etj., por kur jepen me kontratën e emfiteozës, jepen për të ruajtur funksionin që kanë, jo për ta tjetërsuar.

Ndërkohë, edhe bashkitë kanë sfida të tjera, si për strehimin, për qendrat rezidenciale etj., të cilat janë krijuar nga vetë procesi ku ne jemi. Nuk mund të jepet një aset publik pa u konsultuar me ministrinë përkatëse, që ka funksionin e kryerjes së shërbimit arsimor atje. Nuk mund ta bësh një gjë të tillë! Ne jemi shumë dorëlëshuar në ofertën ndaj privatëve, në dëm të interesit publik. Prandaj e kam edhe në sensin e rasteve praktike me të cilat ndeshemi në këtë lloj menaxhimit. Ky problem duhet diskutuar edhe në qeveri, jo thjesht në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, por edhe në raport me kompetencat që ka pushteti vendor. Vërtet, pushteti vendor është pronari i ligjshëm i tyre, por misionin e arsimit në rastin konkret e ka Ministria e Financave dhe e Ekonomisë për arsimin profesional dhe Ministria e Arsimit për arsimin tjetër.

Ndërkohë, ne po flasim këtu për arsimin parauniversitar. Do të shkojmë drejt mbylljes së klasave kolektive. Por ndërkohë ku do t'i përqendrojmë këta? Do të ketë funksione që do të kryhen me shërbim transporti, por do të ketë edhe funksione që do të kryhen me konvikte. Prandaj duhet të jenë në akord, jo lëmsh te bashkia dhe ndryshe te pushteti qendror.

Meqenëse e mora fjalën, kam edhe një pyetje, që e harrova pak më parë: çfarë do të bëhet me qendrën e formimit profesional në Berat, se ka dy vjet që është ndërtuar, ka 12 klasa, është pa staf dhe pa pajisje?

Stavri Lako – Nuk e di nëse drejtoresha mund të shtojë ndonjë gjë, por, në dijeninë time, ajo ka probleme ndërmjet pushtetit vendor dhe firmës së ndërtimit. Godina ka përfunduar, madje unë isha para disa muajsh dhe nuk arrita ta vizitoja. Po shoqëronim disa ekspertë të Bashkimit European...

(Deputetja Rista ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, dhe ka probleme.

Për këtë është në dijeni edhe ministri Ahmetaj dhe besoj se duhet ta zgjidhim sa më shpejt, pasi është një nga detyrimet...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dajna Sorensen – Kemi edhe një projekt të GIZ-it, që ka marrë përsipër ta mbështesë këtë qendër me kurrikula, me projekte dhe programe të reja.

Stavri Lako – Godina ka përfunduar.

Dajna Sorensen – Për sa i përket pjesës së Dibrës, jam shumë e qartë, e kemi parasysh dhe do të mundohemi maksimalisht që të...

Stavri Lako – Është në negociata faza e dytë.

Dajna Sorensen – Jo, është projekt...

Stavri Lako – Po, është projekt i financuar nga qeveria zvicerane dhe ato po kërkojnë të marrin edhe disa shkolla të tjera.

Dajna Sorensen – Mund të marrin edhe disa shkolla të tjera, por kjo do të jetë në varësi edhe të aftësive të tyre për t'u hapur gjeografikisht. Megjithatë është një nevojë tejte e munguar për arsim profesional cilësor në zonën verilindore të Shqipërisë; kjo pjesë është e padiskutueshme.

Për sa u përket panaireve të punës, këto janë realizuar vitin e kaluar nga panaire pune në secilin qark. Për herë të parë janë organizuar në Tiranë, rrallëherë nëpër qarqe, madje në Fier u bë dy herë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, ishin dhjetë panaire të ndryshme në dhjetë qarqe.

Vetëm Kukësi...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Elira Çaushi – Pjesëmarrja këtë vit ka qenë shumë e lartë, si rrallëherë, madje numri i shtuar i vendeve të lira të punës ka ardhur edhe si rrjedhojë e zhvillimit të panairove. Ky është një oportunitet shumë i madh, i vlerësuar nga të gjithë aktorët e tregut të punës qoftë nga bizneset, qoftë nga punëkërkesit apo edhe nga qendrat e formimit profesional. Gjithashtu, kemi marrë edhe përfaqësues nga institucionet shtetërore që ofrojnë punësim, siç janë: DAP-i ose DAR-i, që ka procedurat e tij për të punësuarit në fushën e arsimit. Mund të them se kjo ka qenë një eksperiencë mjaft e mirë dhe është planifikuar të zhvillohen përsëri. Do të jenë deri në 12 panairore dhe me kohëzgjatje shumë të madhe. Këtë vit ishte një eksperimentim për ta shtrirë në të gjitha rajonet, çka u pa se ishte shumë i suksesshëm, me një numër tejet të lartë vizitorësh, pjesëmarrja, interesi po ashtu, si dhe të gjithë pjesëmarrësve u janë mbuluar shpenzimet nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Besoj se kjo do të jetë një praktikë që do të vijojë edhe në vitin 2019.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Stavri Lako – Po ashtu, edhe në fushën e arsimit profesional ka një përvojë në këtë drejtim. Pra, krahas panairove të punës, ku shkollat dhe qendrat marrin pjesë, ne organizojmë panairot tona rajonale të aftësimit profesional, të cilat kulmojnë pastaj me një panair olimpiadë, diku ndërmjet prillit dhe majit, që organizohet në Tiranë.

Dajna Sorensen – Për sa i përket...

Milva Ekonomi – Po për PR-in në këto panairore, jo vetë panairi, kush është në krye? Kush merret, le të themi, me propagandën marketuese për panairot? A ka ndonjë gjë të veçantë?

Dajna Sorensen – Përgjegjës për këtë aspekt jemi ne, si Shërbim Kombëtar i Punësimit, bashkë me Ministrinë e Financave; kemi faqet zyrtare, që promovojnë të gjithë aktivitetin, njoftimet paraprake, por janë edhe faqet zyrtare që kanë vetë qendrat, zyrat e punës apo qendrat e formimit profesional. Patjetër, e gjithë kjo reflektohet në faqen www.puna.gov.al, ku shpallim vendet e lira të punës, të bashkëpunimit me bizneset, për ato që bien dakord që t'i shpallin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – E dini pse e mora fjalën për këtë gjë? Dua të bëj një replikë të vogël, sepse po të shikoni televizionet përfaqësojnë nesh, për shembull, ato italiane, organizojnë një emision që është shumë i zakonshëm: një njeri del dhe konkurron për të gjetur profesionin që kryen njëri nga ata që është shfaqur atje. Shikon aty se ka profesione të ndryshme dhe cilësi të ndryshme për ta bërë një profesion, sepse cilësia individuale lidhet me aftësinë profesionale dhe kjo është një mënyrë për të kuptuar gamën e punëve që ka shteti italian. A e kemi marrë ne përsipër këtë gjë, sepse unë

udhëtova vetë vitin e kaluar nëpër Shqipëri dhe pashë se nevoja e panairove ishte një domosdoshmëri për të shkuar te puna?

Dajna Sorensen – Pikërisht.

Milva Ekonomi – Se nuk është më një gëzim për të bërë panairin, por është domosdoshmëri. Ndoshta mund ta mendojmë edhe këtë, që të njohim punët në Shqipëri. Ne nuk njohim punët që ka Shqipëria. Them se kjo mund të ishte një ide.

Elira Çausi – Në fakt, po përgatisim një dokument strategjik, sepse “strategji” do të ishte fjalë e madhe, për pjesën e promovimit, ku do të përfshihej pjesa e komunikimit dhe e promovimit. Ky është një element shumë i rëndësishëm për Shërbimin Kombëtar të Punësimit. Ne po e përgatisim. Rishikimi i faqes do të jetë pa dyshim një nga prioritetet tona për këtë vit, bashkë me promovimin dhe jo vetëm, por edhe nëpër rajone, si të thuash, do të ndërtojmë strategjitë lokale se si ato do t’i promovojnë. Por panairi është pjesë e kësaj strategjie.

Jam shumë dakord që duhet një fokus tjetër për ta bërë Zyrën e Punës më atraktive, sidomos për punëdhënësit, që ata të shprehen lirshëm dhe të ofrojnë vendet e tyre të punës, por, nga ana tjetër, edhe që t’i nxitin punëkërkuarit për ta rifreskuar databazën që kemi, sepse do të ketë nevojë gjithnjë për të lëvizur, për të qarkulluar.

Etleva Gjellaj – Në lidhje me informacionin se ku është puna në Shqipëri, ne jemi duke ndërmarrë krijimin e sistemit të ri informatik dhe, në lidhje me këtë të fundit, një pjesë shumë e rëndësishme e faqes sonë të re të internetit, që do të rikonstruktohet pas ngritjes së këtij sistemi, është edhe harta digjitale e vendeve të lira të punës të shpallura pranë zyrave të punësimit. Ky është një element shumë i rëndësishëm për të gjithë, në mënyrë që të gjitha ato që përmbahen brenda sistemit tonë *intranet* të kemi mundësi t’i shfaqim edhe jashtë tij, qoftë në mënyrë grafike, qoftë si hartë. Kështu, çdo individ i interesuar për të ditur se çfarë lloj pune është, ku ka më shumë punë, çfarë kategorish janë ose çfarë profesioneve janë, mund t’i gjejë me shumë lehtësi nëpërmjet faqes sonë të internetit. Kjo është pjesë e të gjithë ristrukturimit informatik të informacionit të ne.

Milva Ekonomi – Sistemet e informimit, si të thuash, për tregun e punës do të jenë?....

Dajna Sorensen – Në lidhje me këtë, kemi edhe listën kombëtare të profesioneve që ka dalë shtatorin e vitit të kaluar, ka dalë lista e re e klasifikimit të profesioneve në Shqipëri, çka është shumë e rëndësishme dhe që duhet...

Etleva Gjellaj – Përfshirë në sistemin tonë.

Dajna Sorensen – Po, pikërisht në sistemin tuaj.

Tani, në lidhje me një çështje, që doli në mënyra të ndryshme, por që e përmendët edhe ju, zonja Milva, unë mund ta marr pak më gjerë, sepse ju e fokusuat te punësimi dhe formimi profesional në agroturizëm, pra do ta shikoja më tepër në përgjithësi për tregun e punës në zonat rurale. Ky është një treg pune që ne nuk e njohim, të jemi realisht të sinqertë, e përmendi edhe zotëria, se sa për qind kemi të punësuar në zonat rurale, sa janë të vetëpunësuar, sa janë realisht duke punuar me parcelat e tyre prej 1,2 hektarësh mesatarisht. Domethënë, është një *concern* real, është një problematikë reale dhe ne nuk është se kemi një tablo të qartë të situatës së punësimit në zonat rurale. Edhe anketa e forcave të punës nuk është se të jep informacion të detajuar, madje nuk bën as diferencimin ndërmjet zonave urbane dhe atyre rurale.

Sikurse ne ndërmorëm një anketë të nevojave për aftësi në ekonomi në përgjithësi, sektorin e agropërpunimit dhe ndërmarrjet bujqësore i lamë totalisht jashtë kësaj analize. Por së bashku me një projekt që na mbështet në këtë fushë jemi duke ndërmarrë, pra supozojmë se në fillim të vitit 2019 do të bëjmë një analizë të nevojave për aftësi pikërisht në zonat rurale. Një pikënisje jona mund të jetë projekti i “100 fshatrave”, që të paktën të fillojmë ta bëjmë atë vlerësim dhe atë analizë në këto 100 fshatra, gjithnjë në këndvështrimin se si mund t’u përgjigjemi mbrapsht me shërbime të formimit profesional dhe me shërbime të punësimit në guida turistike, kulinari, agroturizëm, agropërpunim apo në shumë fusha të ndryshme, sipas specifikave të zhvillimit të këtyre zonave. Në radhë të pare, kemi nevojë të bëjmë një vlerësim të plotë të situatës së punësimit në zonat rurale.

Një nga sektorët që ka potencial shumë të madh për të punësuar është bujqësia. Mund të duket deri diku absurde, sepse në totalin e saj numri i personave të punësuar ose të vetëpunësuar në bujqësi është në rënie, por ajo çfarë mund të synojmë ne është rritja e punësimit të paguar në bujqësi. Objektivat tona për sa i përket punësimit në këtë sektor lidhen në mënyrë eksplicite me punësimin e paguar. Sa njerëz marrin aktualisht një pagë të mirëfilltë dhe nuk janë thjesht të vetëpunësuar në këtë sektor. Nuk besoj se kam harruar ndonjë pyetje pa u përgjigjur.

Almira Xhembulla – Meqenëse folët për vlerësimin që doni të bëni në sektorin bujqësor, nga eksperiencia di që është një nga sfidat kryesore, sepse njerëzit që punojnë në bujqësi në përgjithësi janë kategori me nivel ekonomik shumë të ulët dhe nuk janë aq të hapur dhe transparentë për ta dhënë informacionin deri në fund. Kështu që, mirë është të mendohet për një mekanizëm i cili krijon besim tek individët, në mënyrë që ata të japin një informacion, sepse ata stepen, duke menduar se do të hyjnë në listat e të punësuarve. Sa herë i pyet, të thonë në mënyrë

kategorike që janë të papunë. Kështu që, duhet të gjendet një mekanizëm që krijon besim, në mënyrë që ata ta japin informacionin e plotë dhe të jenë shumë të hapur ndaj një qasjeje, për t'i ndihmuar më vonë ata.

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Është kënaqësi të bisedosh me ju të katërt!

Kemi nevojë për pyetje apo sqarime të tjera?

Nëse keni, neve na duhet pak më tepër informacion për sektorin e naftës, sepse, siç e patë, duam të bëjmë diçka për këtë sektor bashkë me Komisionin e Veprimtarive Prodhuese.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem, mos e merr fjalën! Më lejo të mbaroj

(Ndërhyrje pa mikrofon,)

Të lutem, Ismet!

Ismet Beqiraj – Ta marrin parasysh, sepse herë tjetër unë do të jem fontanë.

Milva Ekonomi – Dakord.

Ju falenderoj dhe kërkoj nga ju që këto materiale, që thatë se mund të na i vini në dispozicion nëpërmjet *e-mail*-it, të na i dërgoni që sot. Ne duhet të diskutojmë diçka për buxhetin faktik. Do të kemi gjithmonë dëshirë të flasim me ju për situatën e arsimit profesional dhe formimit profesional. Do ta ndjekim zhvillimin e *site* të informacionit online për këtë gjë.

Suksese në të gjithë këtë punë që keni marrë përsipër!

Faleminderit dhe punë të mbarë!

Anëtarët e komisionit të qëndrojnë edhe pak, sepse duhet të diskutojmë edhe disa gjëra të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vilma thotë se është hera e parë që komisioni mori vlerën e vetë reale: bëri pyetje për të kuptuar situatën.

Kam dy gjëra:

Ne kemi nesër një dëgjese me ministren e Arsimit. I kemi kërkuar informacion për arsimin parauniversitar dhe të na informojë se si filloi viti i ri shkollor. Ju kujtohet që e shtymë, sepse Fideli tha që të mos e bëjmë këtë gjë pa opozitën, por unë mendoj se duhet të vijë dhe nuk mund të shtyhet, sepse opozita mund ta bojkotojë për një kohë të gjatë parlamentin. Sa herë jemi takuar të gjithë, kemi pasur shqetësime: transportin Ismeti, klasat kolektive të gjithë ne apo si u

shpërndanë tekstet. Në fillim situata ishte shumë shqetësuese, pastaj u qetësua, sepse tekstet u shpërndanë. Të kuptojmë njëherë si shkoi e gjitha kjo.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kjo është për t'u bërë nesër.

Lidhur me ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jua kam kërkuar dhe kanë thënë që do t'i sjellin sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Janë lajmëruar për të sjellë materialin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bashkë me Komisionin e Çështjeve Sociale kemi për të diskutuar projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”, për të cilin ne jemi komision për dhënie mendimi. Nuk e kam diskutuar me Elisën, sepse edhe atje komisioni kryesohet nga opozita, por ata nuk marrin pjesë, nëse do të bëjmë një dëgjuesë të përbashkët apo të ndarë. Më lini ta konfirmoj me Elisën ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mund të bëjmë një diskutim të premtën në mëngjes ose të hënën e ardhshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është iniciativë e Braçes.

Përveç kësaj, ne nuk kemi shumë aktivitete të tjera, sepse nuk ka ardhur akoma buxheti i vitit 2019.

Ne kemi disa institucione në varësi, prandaj siç bëjmë vizitë në Radiotelevizion, të bëjmë vizita të tjera në institucione të tjera të varësisë, sepse ushtrijmë kontrollin tonë parlamentar.

Për shembull, ne kemi në varësi Agjencinë Kombëtare të Provimeve. Institucionet e varësisë kanë ndryshuar. Kanë dalë tri institucione të reja: Qendra e Shërbimeve Arsimore, e cila bën kontrollin e cilësisë së përgjigjeve të provimeve universitare ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë po bëj një listë me këto aktivitete. Po mundohem të gjej aktivitete për ditët e hëna, të marta dhe të mërkura, pa ardhur buxheti, në mënyrë që të shkojmë t'i shikojmë këto gjëra.

Me mbështetjen e OSBE-së në muajin nëntor do të zhvillojmë një vizitë në Gjirokastër, të cilën nuk mund ta shtyjmë më, sepse kemi dhënë fjalën që do të shkojmë. Ndërkohë, kemi edhe

gjëra të tjera për të parë. Për shembull, mund të shkojmë te Muzeu Arkeologjik në Durrës, në Apoloni apo në një institucion sporti, sepse e kemi në angazhimin tonë që të shkojmë në një institucion sporti. Për shembull, në Agjencinë e Shërbimit të Sporteve, sepse ne nuk e dimë çfarë bën kjo agjenci. Mund të shkojmë në një drejtori të trashëgimisë kulturore në një qark për të parë se si po i zbatojnë detyrat e reja që u ka vendosur ligji.

Vendosim në prioritet dëgjesat dhe vizitën e përbashkët me Komisionin e Veprimtarive Prodhuese dhe pastaj bëjmë një kalendar me këto institucione varësie.

Jeni dakord?

Maksimumi nesër unë ju dërgoj në *e-mail* çfarë do të bëjmë gjatë tetorit dhe nëntorit, duke lënë edhe ditë për dëgjesat e buxhetit. Për buxhetin e vitit të shkuar kemi bërë shumë dëgjesa.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në përgjithësi, kur kanë nevojë komisionet e tjera, bëjnë takime edhe ditët e premtë. Ne mund ta caktojmë vetë, por në Komisionin e Sigurisë, ku unë jam zëvendësuese, jemi mbledhur edhe ditët e premtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, tani po.

MBYLLET MBLEDHJA

